



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Studime Politike
dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit”**

ofruar nga

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Merita Xhumari

Prof.Assoc.Dr. Elda Zotaj

Dhjetor/20224

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.askal.al

E-mail: info@askal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”				
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane				
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit”				
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 482, datë 03.10.2011				
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Riorganizimi miratohet me shkresë të MASR nr. 2752/1 prot, datë 24.04.2018				
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 377, datë 23.10.2020				
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër MASH Nr. 291, datë 11.07.2012; VBA Nr. 63 datë 28.09.2018				
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë				
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike				
10	Kreditet në total (ECTS):	120				
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë				
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip				
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-				
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-				
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-				
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7				
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Tituj/grada	2021 - 2022		2022 - 2023	
			PAE	PAK	PAE	PAK
		Prof.Dr	1	-	1	-
		Prof.As.Dr	1	-	1	-
		Dr/PhD	6	1	5	2
		Msc	-	-	-	-
Në total		8	1	7	2	

18	Numri i studentëve:	2020-2021 të regjistruar 42 studentë + 3 transferime; 2021-2022 të regjistruar 43 studentë + 1 transferim; 2022-2023 të regjistruar 45 studentë.
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi në proces të vlerësimit të jashtëm Master i Shkencave "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit" ka një evoluim që në vitin 2011, me vendim të UMSH Nr. 482, datë 03.10.2011 për hapjen e Programit Master i Shkencave në Shkenca Politike, me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Me Vendim të Senatit Akademik nr.6/1, datë 19.05.2017, programi kalon nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në Fakultetin e Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ku ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike. Ndryshimet e bëra dhe të deklaruara nga Institucioni, në masën 20%, referuar Vendimit të Senatit Akademik të UMSH Nr. 6, datë 07.02.2018 për programin e studimit Master Shkencor në "Shkenca Politike" i cili ndryshon në Master i Shkencave në "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit" miratohen me shkresë të MASR nr. 2752/1 prot, datë 24.04.2018, i cili aktualisht ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, UMSH.

Pra, nga viti akademik 2018-2019, ka ndryshuar emërtimi i programit të studimit si dhe janë zëvendësuar 3 lëndë të programit të vjetër duke futur 3 lëndë të reja, ndryshime të vlefshme aktualisht për këtë process akreditimi. Akreditimi i parë: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 291, datë 11.07.2012 (kohëzgjatja 6 vite). Akreditimi periodik: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 63, datë 28.09.2018 (kohëzgjatja 5 vite, me afat 30.09.2023) me emërtimin MSh në Shkenca Politike, por që në shkresën e UMSH nr.1080, datë 02.08.2023, ku përcillen Planet e Veprimit për përbushjen e rekomandimeve të Bordit të Akreditimit, drejtuar ASCAL dhe Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, emërtimi është Master i Shkencave "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit". Fusha akademike e programit të studimit dhe Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare i takon fushës së studimeve Sociale (kategoria nr.3), kurse Fakulteti ku ai ndodhet i Drejtësisë dhe Shkencave Humane është një miksim i dy fushave të tjera të studimit, asaj të Shkencave Humane (kategoria nr.2) dhe Biznesit e Drejtësisë (kategoria nr.4) sipas klasifikimit ndërkombëtar ISCED 2011.

Kurrikula e programit të studimit ofron formim në shkencat politike dhe ekonomike, e marrëdhëniet ndërkombëtare. Qëllimi i tij është të përgatisë profesionistë të aftë për institucionet

kombëtare dhe ndërkombëtare, referuar objektivave të tij dhe praktikave ku orientohen studentët, apo studentëve të diplomuar. Format e mësimdhënies përfshijnë orë në auditor, punë në grup dhe punë kërkimore individuale. Syllabuset përmbajnë elementët e nevojshëm dhe forma e vlerësimit të studentit është kombinimi i punimit të eseve, me provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare të lëndës, apo projektet e kursit. Personeli akademik ka kualifikimin e përshtatshëm, me eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka edhe një rrjet bashkëpunëtorësh me të cilët ka nënshkruar marrëveshje, si për projekte të përbashkëta shkencore, edhe për praktikat e studentëve dhe mundësitë e punësimit të tyre pas diplomimit.

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit përfshijnë të gjithë aktorët e interesuar, strukturat, stafet akademike, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Ato diskutohen në takime dhe evente të organizuara në UMSH. Infrastruktura garanton cilësi dhe akses të barabartë për përdorimin e teknologjive të informacionit, bibliotekës online dhe internetit në të gjitha mjediset.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), në përputhje me procedurën e vlerësimit të ASCAL, fillimisht është njohur me dokumentacionin që Institucioni ka vënë në dispozicion në faqen online të ASCAL, dhe më pas ka kryer konfirmimin e standardeve përmes vizitës në UMSH me datë 5 dhe 6 Shkurt, 2024. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin një situatë sa më reale, për mënyrën se si performon institucioni në ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit". Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat GVJ është njohur që në fillim të angazhimit të tij. GVJ është i përbërë nga ekspertët Prof. Dr. Merita Xhumari dhe Prof.Assoc. Elda Zotaj, asistuar nga Rajna Lila, përfaqësuese e ASCAL.

GVJ pasi ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e referuara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, konfirmimet gjatë bisedave në institucion, pyetjeve të drejtuara stafeve menaxheriale dhe akademike të UMSH, si dhe studentëve gjatë vizitës në institucon, sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga përfaqësues të ASCAL (Agjenda bashkangjitur). Gjatë vizitës dhe vlerësimit u vu re një disponibilitet nga strukturat akademike dhe administrative të institucionit për t'i vënë në dispozicion GVJ dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e programit. Drejtuesit e institucionit, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare shpjeguan riorganizimin e programit të studimit për rritjen e profesionalizmit dhe atraktivitetit të programit të studimit. Bisedat me stafin akademik dhe studentët ofruan informacion të drejtpërdrejtë të përpjekjeve të



tyre për përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Takimi me përfaqësues të NJSBCZHK dhe të Drejtorisë së Kurrikulave konfirmuan faktet për proceset e sigurimit të cilësisë, sikurse edhe biseda me studentët në UMSH. Kontaktet gjatë vizitës u përmyllën me shqyrtimin e të dhënave statistikore në sekretaritë mësimore dhe inventarit të fondit të Bibliotekës, me njohjen e mjediseve, sallave, auditoreve, laboratoreve ku zhvillohej procesi mësimor për këtë program studimi. Vlerësimi është pozitiv me pikat e forta të identifikuar dhe disa nota të lehta kritike. GVJ është i mendimit se programi i ka përmbushur plotësisht kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i akreditimit.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 63, datë 28.09.2018 janë:

1. Institucioni të përshtasë planin mësimor të programit të studimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi si vijon, duke përfshirë lëndë me zgjedhje si pjesë e aktiviteteve formuese të kategorisë E.
2. Institucioni të përshtasë planin mësimor të programit të studimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, rishikimi i krediteve dhe ngarkesës së Mikrotezës.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Në shkresën e UMSH nr.1080, datë 02.08.2023 drejtuar ASCAL për Planet e Veprimit përcaktohet përmbushja e rekomandimeve të Bordit të Akreditimit për programin Master i Shkencave "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit", sikurse theksohet edhe në raportin e Vlerësimit të Brendshëm (faqe 3). Në lidhje me rekomandimet e pikës a, UMSH dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vazhdimësi kanë bërë rishikimin në planet mësimore ku gjashtë (6) prej lëndëve tyre janë të përbashkëta dhe tre (3) prej tyre të ndryshme. Programi Master Shkencor është rimodeluar, por ende mbetet detyrë e institucionit të vazhdojë të përshtasë planin mësimor të programit të studimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi duke përfshirë lëndë me zgjedhje si pjesë e aktiviteteve formuese të kategorisë E, ku mbetet vetëm mikroteza me 18 ECTS (Evidenca 14.)

Në këtë mënyrë, UMSH nuk ka përmbushur plotësisht rekomandimin në pikën a.

Në lidhje me rekomandimet e pikës b, institucioni menjëherë pas akreditimit dhe në vazhdimësi, bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ka vendosur që kreditet e mikrotezës

së diplomës të jenë 18, dhe të praktikës 12. Ndërsa i rekomandohet institucionit të përditësohen kreditet për mikrotezën nga 20 ECTS në 18 ECTS, sikurse edhe për praktikën nga 15 ECTS në 12 ECTS në faqen zyrtare të UMSH, referuar në linkun:

<https://www.umsh.edu.al/media/6530f0148a8e1.pdf> (parë me 21.04.2024, ora 8:00 am).

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi Master i Shkencave “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit”, i ofruar nga Fakulteti të Drejtësisë dhe Shkencave Humane (FDSHH) të UMSH, është ristrukturuar dhe riemërtuar që të jetë në harmoni me interesat kombëtare të vendit, duke kontribuar në formëzimin e specialistëve të fushës të aftë të zhvillojnë më tej Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ky synim është i shprehur qartë edhe në Statutin e UMSH ku programet e tij ruajnë dhe konsolidojnë vlerat akademike e kulturore kombëtare. Brenda këtij kuadri statutor dhe bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, UMSH ka rregulluar dhe ristrukturuar edhe programin e studimit. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH.</i> https://www.umsh.edu.al/c/14/misioni-dhe-filozofia
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet	Programi Master i Shkencave “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit” është në përputhje me misionin dhe



në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	qëllimet e UMSH dhe me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. <i>Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Referuar evidencave mbi dokumentet strategjike dhe bisedave me drejtuesit e UMSH, konfirmohet se Programi i studimit është riorganizuar për t'ju përshtatur më mirë Planit strategjik të zhvillimit, statutit dhe rregullores së UMSH. Institucioni ka një vizion të qartë për zhvillimin afatgjatë të studimeve në fushën e shkencave politike të lidhura me ato ekonomike, në kuadrin e strategjisë të institucionit. Programi i studimit reflekton plotësisht drejtimin akademik të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ konfirmon se nga shqyrtimi i dokumentacionit të UMSH dhe bisedat me stafet drejtuese të institucionit, riemërtimi i programit të studimit përputhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim të qeverisë shqiptare dhe prirjet globale të zhvillimit ku politika është në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Ai është në harmoni me interesat kombëtare të vendit, duke kontribuar në formëzimin e specialistëve të fushës të aftë të zhvillojnë më tej politikat ekonomike në vend dhe të japim kontribut në zhvillimet rajonale dhe globale. <i>Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i>
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, konfirmon se UMSH ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Konkretisht programi i studimit synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UMSH. Programi i studimit është riorganizuar për t'ju përshtatur më mirë Planit strategjik të zhvillimit, statutit dhe rregullores së UMSH. Ai është duke kontribuar në formësimin e specialistëve të fushës të aftë të zhvillojnë më tej Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.</i>

Mase



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UMSH demonstroi përvojën mbi 10 vjeçare në Programin Master i Shkencave në Shkenca Politike, që në vitin 2011, i cili aktualisht rrimëtohet Master i Shkencave “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit”. Stafi akademik përbëhet nga studiues dhe personalitete të kualifikuara dhe me përvojë edhe më të gjatë në fushën e Shkencave Politike, si kushti kryesor për zhvillimin e programit të studimit. <i>Evidenca 16. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit: Tabela 1; Tabela 2.</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit, i takon fushës së studimit të Shkencave Humane (nr.2) dhe Biznesit e Drejtësisë (nr.4), ndryshe nga program që i takon Shkencave Sociale (nr.3) sipas klasifikimit ISCED 2011. Programi Master i Shkencave “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit” organizohet në nivelin 7 sipas kornizës evropiane dhe kombëtare të kualifikimeve. (Të saktësohet shifra 15 vjeçare tek RVB, pasi referuar dokumentacionit të UMSH, program i ka fillesat në 2011). <i>Evidenca 7. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 14.3 CV e stafit akademik të programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore,	Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të Masterit në Studime Politike dhe Ekonomike përputhet me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Njësia bazë është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat e nevojshme për të ofruar një program të tillë. Si një program ndërdisiplinor ku ndërthuren shkencat politike edhe ato ekonomike, të dyja këto disiplina i takojnë kategorisë së Shkencave Sociale (nr.3) sipas klasifikimit ISCED 2011.

Maso


të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ky klasifikim është sanksionuar edhe nga qeveria shqiptare me VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022. <i>Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN.</i> <i>Evidenca 16. Përmbledhëse e Tabelave për programin: Tabela 9; Tabela 10.</i>			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nuk aplikohet.			
Konkluzione	GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, konfirmon se Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat për të ofruar një program të tillë Master Shkencor. Si një program ndërdisiplinor ku ndërthuren shkencat politike edhe ato ekonomike, të dyja këto disiplina i takojnë kategorisë së Shkencave Sociale (nr.3) sipas klasifikimit ISCED 2011. Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit në Shkenca Sociale (Kategoria nr.3) me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane (miksime të Kategorive nr. 2 + nr.4) sipas standardeve ndërkombëtare ISCED 2011, kërkohet reflektimin nga institucioni që të përmbushë si standardet ndërkombëtare ISCED, edhe legjislacionin shqiptar si VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiwe në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit është e përcaktuar në Statutin dhe Rregulloret e UMSH, FDSHH, DSHPMN dhe programit të studimit. Programi zbatohet nga njësi bazë DSHPMN si përgjegjësiwe kryesore. Për mbarëvajtjen e programit, departamenti ka marrëdhënie me njësi të tjera të Fakultetit dhe të Universitetit, sikurse u konfirmua nga takimet me drejtuesit e FDSHH dhe DSHPMN gjatë vizitës në institucion. Bashkëpunimi lidhet me aspekte të realizimit të lëndëve të programit mësimor, burimeve njerëzore dhe sigurimit të cilësisë. <i>(Ref. Evidencë 1. Statuti i UMSH; Evidencë 2. Rregullore e UMSH; Evidencë 6. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Evidencë 7. Rregullorja e masterit; Evidenca 18. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK; RVB, fq. 7; Takimet me drejtuesit e FDSHH dhe DSHPMN, dhe me përfaqësuesit e drejtorive administrative të institucionit).</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimet në institucion dhe website i UMSH evidentohet se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, Universiteti shfrytëzon marrëveshjet e mobilitetit Erasmus + dhe Horizon 2020 me universitete të ndryshme që mundësojnë shkëmbime të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve për të qenë pjese e mobiliteteve, trajnimeve, pjesëmarrjes në aktivitete dhe projekte kërkimi, praktika mësimore, punësimi dhe zhvillimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar etj. <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH.</i> https://www.umsh.edu.al/d/365/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-marreveshje-me-european-law-governance-school-te-athines https://www.umsh.edu.al/d/359/nenshkruhet-marreveshja-me-qendren-e-koordinimit-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem

Mase


Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Nga takimet në UMSH me stafin akademik të DSHPMN dhe studentët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konfirmohet se institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me institucione që ofrojnë mundësitë për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Praktikave profesionale realizohen në bazë të marrëveshjeve që institucioni ka me organizma të ndryshëm. Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale. UMSH ka nënshkruar marrëveshje me institucione sikurse në rastin e bashkëpunimit me institucionet publike, bizneset private apo organizatat profesionale. Gjatë bisedës me studentët rezultoi se ata kanë liri të zgjedhin dhe negociojnë mundësitë për kryerjen e praktikës profesionale në institucionet me të cilat janë në kontakt. Në shumicën e rasteve, praktika profesionale drejtohet nga iniciativa e studentëve. Secili student mbikëqyret nga një supervisor te institucioni pritës. Përshkrimi i detajuar i punës nga vetë studentët dhe vlerësimi i institucionit janë elementët kyç të vlerësimit të praktikës. Kjo evidentohet në marrëveshjet e nënshkruara dhe në dokumentat për vlerësimin e praktikës, përkatësisht formularët dhe raportet e internshipit, që dorëzohen nga studentët UMSH bën të dukshëm informacionin për këto marrëveshje për të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare, sikurse e evidentuam gjatë takimit me përfaqësuesen e burimeve njerëzore. Bashkëpunimi me institucionet homologe është materializuar përmes mobilitetit të personelit në universitetet në Poloni, Itali, Ruman, Portugali, Estoni, Greqi, Bullgari, Turqi etj. Këto shkëmbime, sikurse treguan pedagogët e departamentit, që reflektoheshin edhe në dosjet e tyre, përfshijnë edhe punë kërkimore të përbashkët të stafit tonë me kolegët në universitetet pritëse. <i>Evidenca 13. Udhëzim për praktikat dhe Formularët dhe formularët tip të praktikës mësimore (F.14 -F.18).</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga takimet në UMSH me drejtuesit e FDSHH dhe stafin akademik të DSHPMN, GVJ konstatoi se ata i konsideronin marrëveshjet me IAL homologe të rëndësishme për përmirësimin e programit përmes përafrimit të kurrikulës, pasurimit të literaturave, mobilitetit të pedagogëve e studentëve dhe aktiviteteve të përbashkëta si konferenca, trajnime, etj. Ndërsa marrëveshjet me institucionet vendase vlerësohen në aspekt të bashkëpunimit për praktikën mësimore, tërheqjen e opinioneve për nevojat e tregut të punës dhe aktivitete të tjera.




Konkluzione	GVJ vlerëson përmbushjen e standardit plotësisht, pasi bëri një shqyrtim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL homologe të rëndësishme për përmirësimin e programit përmes përafrimit të kurrikulës, pasurimit të literaturave, mobilitetit të pedagogëve e studentëve dhe aktiviteteve të përbashkëta si konferenca, trajnime, etj. Ndërsa marrëveshjet me institucionet vendase, publike, OSHC dhe biznese private vlerësohen në aspekt të bashkëpunimit për praktikën mësimore, tërheqjen e opinioneve për nevojat e tregut të punës dhe aktivitete të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Përmbajtja dhe struktura e programit, syllabuset e lëndëve dhe organizimi në 4 semestra, përcaktojnë qartë qëllimet, objektivat, dijet dhe kompetencat që studentët përfitojnë në përfundim të kursit. Struktura për çdo semester ka 30 ECTS për çdo semester, githsej programi përmban 120 ECTS sikurse kërkohet për një Master i Shkencave. Programi përmban lëndë të detyrueshme me nga 7-8 ECTS secila; por mugojnë lëndët me zgjedhje. Kjo ndarje respekton por jo plotësisht legjislacionin kombëtar Ligj Nr. 80/2015, datë 25.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

	<i>Evidencë 14. Plani mesimor 22-23; RVB, fq.9).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ nga takimet me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit dhe shqyrtimi i programit të lëndëve të detyrueshme të programit të studimit gjykon se ai ofron njohuri bazë dhe të thelluara, si dhe trajtime të specializuara dhe empirike të çështjeve specifike që lidhen me fushën e Studimeve Politike dhe Strategjive Ekonomike të Zhvillimit. Studentët vinin nga fusha të ndryshme formimi dhe pas diplomimit, përgjithësisht, janë punësuar në administratën publike dhe sektorin privat. Shprehinë që ky program Masteri u ofron i shërbejnë në aktivitetin e tyre të përditshëm në auditor, kurse punimi i diplomës është një projekt kërkimor individual, i cili monitorohet nga një supervisor staf akademik i specializuar në fushën përkatëse të tezës. Njësia bazë angazhon stafet akademike të brendshme dhe ato të jashtme për supervizionin e punimit të diplomës. Gjithashtu, ka një vëmendje të kufizuar ndaj ofrimit të lëndëve me zgjedhje të cilat diversifikojnë specializimet. <i>Evidenca 5. Strategjia e Zhvillimit të Programit MScSPSEZH.pdf</i> <i>Evidencë 14. Plani mesimor 22-23; Syllabuset në Master i Shkencave</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale me 12 ECTS; Punimi i diplomës – Mikroteza 18 ECTS. si detyrim përmbyllës duke respektuar legjislacionin vendas në fuqi. Programi synon të japë njohuri praktike, në bazë të dokumentacionit praktika zhvillohet në një institucion, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Ajo ndiqet nga mentori i Universitetit dhe ai i institucionit. Më pas shoqërohet me dokumentacionin përkatës. Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë : - Lëndë bazë (A) – 15 ECTS – 13 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 61 ECTS – 50 %, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 14 ECTS – 12 % - Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS – 10 %, - Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS – 15 %.



	<i>Evidenca 14. Plani Mësimor i studimit 2022-2023.</i> Evidencë 21. Udhezues për përgatitjen e punimit te diplomes.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet.

Mase


Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet	Nuk aplikohet.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sikurse referohet në RVB, institucioni duket i familjarizuar me klasifikimit ISCED 2011, sepse aty referohen VKM që ky klasifikim është sanksionuar nga qeveria shqiptare si VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022, si edhe Udhëzimi Nr.31, datë 15.11.2022 "Për Procedurat Për Kodifikimin e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Nga bisedat me drejtuesit e institucionit dhe GVB, vlerësohet se ka ende nevojë për qartësime dhe që njësitë përgjegjëse të rishikojnë formulimet e emërtimeve të Fakulteteve, si dhe të bëjnë klasifikimet adekuate të programeve.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet.			
Konkluzione	<i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ vlerëson se institucioni duket i familjarizuar me klasifikimit ISCED 2011, sepse referohet që ky klasifikim është sanksionuar edhe nga qeveria shqiptare me VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022. GVJ vlerëson se ka ende nevojë për qartësime dhe që njësitë përgjegjëse të rishikojnë formulimet e emërtimeve të Fakulteteve, si dhe të bëjnë klasifikimet adekuate të programeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për	Pas shqyrtimit të dokumentacionit bazë të UMSH dhe vizitës në institucion, GVJ gjykon se FDSHH si njësi kryesore dhe



programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

DSHPMN si njësi bazë ku ofrohet programi i studimit, përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik dhe funksionojnë në bazë të legjislacionit mbi arsimin e lartë. FDSHH dhe DSHPMN përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, për vlerësimin dhe akreditimin e programit në tërësi.

Referuar RVB, stafi akademik i Fakultetit përbëhet nga 62 anëtarë nga ku 3 prej tyre janë me titullin profesor, 7 prej tyre me titullin Prof.Asoc. Dr. dhe 42 me gradën Dr. dhe 10 janë me kualifikimin MSc. DSHP ka numrin e nevojshëm të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit prej 15 anëtarësh, nga ku 1 prej tyre me titullin profesor, 2 prej tyre me titullin Prof.Asoc. Dr., 9 me gradën Dr. dhe 3 janë me kualifikimin MSc. Kurse referuar Evidencës 16. Me të dhënat për stafin akademik, numri i personelit akademik të DSHPMN rezulton në 16, ku 11 PAE dhe 5 PAK. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konstatoi se është i depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar dhe të dhënat e personelit përditësohen. GVJ pati mundësi për t'i konfirmuar gjatë vizitës në institucion.

Përbërja e Departamentit paraqitet si në vijim:

Tituj/ grada	2020 – 2021		2021 – 2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	1	-
Prof. Asoc.	1	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	6	1	5	1	6	4
Msc.	2	1	2	2	2	1
Totali	9	2	9	3	11	5

Evidenca 7. Rregullore e FDSHH.

Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN.

Evidenca 16. Përmbledhëse e Tabelave për programin.

RVB, faqe 11.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	FDSHH dhe DSHPMN kanë stafin e nevojshëm ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ligji në fuqi. Nga biseda me personelin akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit, si dhe me konfirmimet nga studentët, GVJ konfirmon se ata kanë një bashkëpunim të ngushtë me institucionet ku zhvillohen praktikat mësimore sipas planit mësimor, në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve Master. GVJ nga bisedat me studentët konfirmoi se Departamenti i drejtonte ata në praktika profesionale si në institucionet publike si Bashkia, ashtu dhe OSHC që operojnë në fushën e studimeve politike. <i>Evidenca 7. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN.</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas përcaktimit në rregulloren e FDSHH, koordinatori i caktuar për mbarrëvajtjen e këtij program studimi është përgjegjës për mbarrëvajtjen e programit të studimit, dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit dhe raporton te drejtuesi i departamentit. Roli i koordinatorit është monitorimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë ndërmjet departamenteve për programin e studimit master si dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale, duke bashkërenduar veprimtarinë ndërmjet departamentit dhe institucioneve publike e jopublike me të cilat ka marrëveshje. <i>Evidenca 7. Rregullore e FDSHH.</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër në lidhje me respektimin e kuadrit legjislativ të sanksionuar edhe në rregulloret e UMSH, Rregulloren e FDSHH dhe të DSHPMN. FDSHH si njësia kryesore dhe DSHPMN si njësia bazë ku ofrohet programi i studimit, përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik dhe funksionojnë duke përmbushur detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, për vlerësimin dhe akreditimin e programit në tërësi, për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet departamenteve si dhe me institucionet jashtë UMSH për praktikat e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit bazë të UMSH dhe vizitës në institucion, GVJ gjykon se FDSHH si njësia kryesore dhe DSHPMN si njësia bazë ku ofrohet programi i studimit, kanë në dispozicion informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit raporton te dekani i fakultetit informacionet e nevojshme që rrjedhin nga studentët, anëtarët e stafit akademik dhe ndihmës akademik/administrative. Kjo evidentohet në dokumentacionin e plotë të programit të studimit si plani mësimor, programi për çdo lëndë (Syllabuset), rregullorja e programit të studimit, stafi i angazhuar për realizimin e programit të studimit, strategjia e zhvillimit të programit të studimit, të depozituara në departament dhe bashkëngjitur dokumentacionit në platformën e ASCAL. <i>Evidenca 7. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidencë 8. Rregullore e DSHPMN</i> <i>Evidenca 14. Plani Mësimor i programit 2022-2022.</i> <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Takimet me stafin akademik, studentët dhe me drejtuesit e FDSHH, DSHPMN.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen në lëndë, praktikë dhe punimi i diplomës të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara brenda dhe jashtë auditorit. Ky program i studimit ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (60 ECTS për vit) ose 4 semestra (30 ECTS për semestër). Planin mësimor jep edhe ngarkesën mësimore dhe orët në auditor ku çdo ECTS përbën 25 orë studim dhe në një vit akademik me 60 ECTS mesatarisht 1500 orë studimi. Planin mësimor është i qartë, në semestrin e parë zhvillohen lëndë plotësuese dhe karakterizuese, të gjitha të detyrueshme. Në semestrin e dytë zhvillohen lëndë bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore integruese. Në semestrin e tretë zhvillohen lëndë karakterizuese dhe ndërdisiplinore integruese. Në semestrin e katërt dhe e fundit zhvillohet një lëndë, praktika mësimore dhe punimi i diplomës. Praktika si lëndë Plotësuese (D) përbën 12 ECTS (10%) dhe Detyrime Përmbyllëse (E), Tema e

	Diplomës ose Mikroteza përbën 18 ECTS (15%). Në program mungojnë lëndët me zgjedhje ndonëse ka qenë një ndër rekomandimet e akreditimit të mëparshëm. DSHPMN për organizimin e veprimtarisë mësimore, këkimore- shkencore dhe administrative, mbështetet në Ligjin Nr.80, datë 22.07.2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të”, VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. <i>Evidenca 14. Plani Mësimor i programit 2022-2023.</i> <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit ka të përcaktuar qartë kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve në programin e studimit Master Shkencor të cilin mund ta ndjekin studentët nga universitetet shqiptare (publike e private), sikurse GVJ e vërtetoi me takimin me studentët ku kishte studentë të cilët kishin fituar diplomën universitare “Bachelor” edhe nga Universiteti i Tiranës, Dept. i Shkencave Politike dhe kishin zgjedhur këtë program Masteri. Pra, sikurse në çdo program Masteri kriteri ishte të kishin grumbulluar 180 kredite ECTS dhe të kenë njohje të gjuhës së huaj sipas kriterëve ligjore ne fuqi, që sekretaria mësimore i kishte dëshmitë për çdo student. Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti kriteret bazë të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS, sikurse kishte student të kthyer nga universitetet jashtë vendit në takimin me GVJ në institucion. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH. <i>Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 16. Broshura e programeve Master.</i> https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6Wmo4Qp-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKQ/viewform




Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit organizohet në lëndë, praktikë dhe punimi i diplomës të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara sipas komponentëve mësimorë formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Lëndët janë të ndara në 6 ECTS për 1 lëndë. Plani mësimor jep edhe ngarkesën mësimore dhe orët në auditor ku çdo ECTS përbën 25 orë studimi (150 orë për 6 kredite). Në programet e lëndëve (syllabuset) si pjesë integrale e planit mësimor gjenden të pasqyruara elementët e përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore (Vendimi Nr. 879, datë 18.12.2019), duke theksuar sidomos përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, objektivat e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit. Vend të vecantë ze përmbajtja e temave dhe çështjet kryesore brenda tyre, shoqëruar me literaturën bazë dhe atë të rekomanduar. Format e mësimdhënies dhe të kontrollit të njohurive për lëndën jepen të detajuara, në funksion të orientimit dhe transparencës ndaj studentëve për vlerësimin e tyre. <i>Evidenca 14. Plani Mësimor i programit 2022-2023.</i> <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Syllabuset janë të detajuara dhe komunikohen vetë studentëve çdo fillim viti akademik, pasi përditësohen sipas nevojave. Rishikimi dhe përditësimi i lëndëve të ofruara nga programi i studimit është kompetence e DSHP, dhe çdo silabus përditësohet dhe miratohet përpara fillimit të çdo viti akademik nga departamenti. Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave”. Analiza e syllabusit merr parasysh të gjithë elementët e tij thelbësorë duke u ndalur në përputhjen e plotë të tij me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara nga UMSH si dhe kërkesat e tregut të punës. Megjithatë, literatura e dhënë në syllabuset, me kalimin e viteve, bëhet e vjetër. <i>Është i nevojshëm përditësimi i vazhdueshëm i literaturës të syllabuset me botimet më të reja. Rifreskimi i literaturës, përshtatja e temave të trajtuara mes formimit teorik të lëndëve dhe zbatimit praktik të tyre, përshtatja e metodave të vlerësimit dhe ndërtimi i procedurave të barazvlerësimit janë nga elementet më të rëndësishëm të rishikimit të syllabusit.</i> Çdo vit akademik DPSHPMN që përgjigjet për programin e studimit bën analizë të syllabuseve të të gjitha lëndëve të programit, sipas procedurave përkatëse dhe në kohë të mjaftueshme përpara



	fillimit të procesit mësimor, për të reflektuar ndryshimet e nevojshme.			
	<i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023.</i>			
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, i është referuar Planit Mësimor dhe Syllabuseve të lëndëve të ofruara në këtë program Master. DSHPMN për organizimin e veprimtarisë mësimore, këkimore- shkencore dhe administrative, mbështetet në Ligjin Nr.80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të", VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL". Plani Mësimor i programit dhe Syllabuset e lëndëve ofrojnë si në përmbajtje, edhe në formë të gjithë informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, duke respektuar si aspektet ligjore edhe rregulloret e brendshme të institucionit mbi kriteret e pranimit dhe transferimet e studentëve. Programi i studimit organizohet sipas strukturës së nevojshme për një program studimi të ciklit të dytë. Është i nevojshëm plotësimi me lëndë me zgjedhje i programit dhe përditësimi i vazhdueshëm i literaturës të syllabuset me botimet më të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit ofron njohuri dhe kompetenca teorike dhe metodologjike, si dhe aftësi të kërkimit shkencor në drejtim të politikave e marrëdhënieve ndërkombëtare të lidhura me zhvillimin ekonomik të qendrueshëm. Ai ka në fokus shpërndarjen e lëndëve dhe praktikave mësimore duke i mundësuar studentëve të programit thellimin e njohurive dhe aftësive që ndihmojnë në zhvillimin e ekspertizës në profile të kërkuara nga tregu dhe të avancimit në karrierë. Në përfundim të programit të studimit, studenti mund të ushtrojë një llojshmëri specialitetesh si nëpunës i administratës publike dhe punonjës në organizata ndërkombëtare dhe jo

Maso


	qeveritare, akademi, institute të kërkimit, organiza biznesi, dhe media, si dhe vazhdimin e një karriere akademike, etj. <i>Evidenca 14. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2022-2023.</i> <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në Planin Mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentit të këtij programi masteri njohuri dhe përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme. Lëndët karakterizuese janë lëndë që i ofrojnë përgatitje të thelluar në fushën e studimit të shkencave politike dhe ekonomike. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 2 vite akademike dhe realizohen me 120 kredite, i strukturuar në dy semestral çdo vit, me nga 30 kredite secili semester. Përveç lëndëve bazë, ofrohen edhe njohuri të thelluara, duke siguruar një përgatitje të mirë në disa drejtime të përshtatshme për nivelin 7 në kornizën kombëtare dhe Evropiane të kualifikimeve. Rëndësia e lëndëve metodologjike si dhe ngarkesa me 18 kredite e Mikrotezës së Diplomës i aftëson dhe përgatit studentët për vijueshmërinë e mëtejshme në studime të ciklit të tretë, doktoraturës. <i>Evidenca 14. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2022-2023.</i> <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit është hartuar në bazë të kriterëve dhe standarteve të ciklit të dytë të studimeve duke kombinuar lëndë të formimit metodologjik bazë, grup-lëndësh karakterizuese dhe lëndët me zgjedhje mungojnë. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formues të programit të studimit dhe sipas përcaktimeve ligjore, duke kategorizuar veprimtaritë formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët/ modulet karakterizuese, të cilat janë tërësisht në përputhje me profilin e programit. Lëndët dhe modulet që ai përmban dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit për ciklin e dytë të studimeve. Ky program studimi është në përputhje me programet të ngjashme dhe praktikatat të mira kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen nëpër universitetet të ndryshme.

	<i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit te programit të studimit.</i> <i>Evidencë 14. Plani mesimor</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e ngarkesës është relativisht e përshtatshme për këtë program studimi dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe lejon transferimin e krediteve/studimeve. Njohuritë e natyrës teorike dhe kombinimi me aftësimin praktik në këtë program u japin studentëve kompetenca, aftësi profesionale dhe personale që përshtaten me kërkesat e pozicioneve të punës në atë çfarë kërkohet sot nga tregu i punës. <i>Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit te programit të studimit</i> <i>Evidenca 14. Plani Mësimor i programit</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programi i studimit është në gjuhën shqipe, por shumë nga detyrat e lëndëve bëhen me literaturë në gjuhën angleze, e cila mundëson përdorimin e literaturës të përditësuar nga autorët dhe shtëpi botuese akademike ndërkombëtare. Programet e lëndëve mbështeten në kombinimin e literaturës dhe leksioneve të shkruara nga pedagogët. Po kështu, në syllabuse literatura e detyrueshme është edhe në gjuhë të huaj, anglisht. Ndërsa syllabuset përditësohen çdo vit, pjesa e literaturës së syllabuseve kërkon vëmendje të veçantë, veçanërisht përse i përket viteve të botimit të literaturës. <i>Evidenca 14. Plani Mësimor i programit.</i> Syllabuset
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ pas takimeve me stafin akademik, me studentët e programit të studimit dhe me drejtuesit e departamentit, sikurse edhe pas shqyrtimit të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit garanton cilësinë dhe përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Synimi i programit lidhet ngushtë me përgatitjen profesionale të studentit dhe nevojat e sektorit publik e jopublik për analiza të politikave të lidhura me zhvillimin e qendrueshëm ekonomik. Programi i studimit lejon specializimin e thelluar të studentit në drejtim të shkencave politike dhe atë të ekonomisë politike duke zhvilluar bazën teorike brenda auditorit, të shoqëruar me elementë të aplikimit në situata praktike në lëndët e formimit të përgjithshëm dhe të specialitetit, por dhe praktikën e vendosur me qëllim profilizues përpara diplomimit të studentëve. Programi ofron njohuri metodologjike, si aftësi dhe njohuri për të aplikuar në mënyrë kritike instrumentet metodologjike të kërkimit, duke

	përfshirë aftësinë për të planifikuar dhe kryer hulumtime të pavarura. <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i> <i>Evidenca 14. Plani Mësimor i programit.</i> Syllabuset
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ pas takimeve me stafin akademik, me studentët e programit të studimit, me drejtuesit e departamentit, dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumnit sikurse edhe pas shqyrtimit të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit pajis studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale me profilizim në fushën e ekonomisë politike për çështje aktuale rajonale dhe globale, e cila mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Në kushtet që UMSH ofron program studimi të ciklit të tretë, Doktoraturë, natyrisht që ky program studimi Master Shkencor e mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve. <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i> <i>Evidenca 14. Plani Mësimor i programit.</i> Syllabuset
Konkluzione	GVJ pas takimeve me stafin akademik, me studentët e programit të studimit, me drejtuesit e departamentit, dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumnit sikurse edhe pas shqyrtimit të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit pajis studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale me profilizim në fushën e ekonomisë politike për çështje aktuale rajonale dhe globale, e cila mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në Planin Mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor. Lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentit të këtij programi masteri njohuri dhe përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme. Lëndët karakterizuese janë lëndë që i ofrojnë përgatitje të thelluar në fushën e studimit të shkencave politike dhe ekonomike. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 2 vite akademike dhe realizohen me 120 kredite, i strukturuar në dy semestral çdo vit, me nga 30 kredite secili

	<i>semester. Përveç lëndëve bazë, ofrohen edhe njohuri të thelluara, duke siguruar një përgatitje të mirë në disa drejtime të përshtatshme për nivelin 7 në kornizën kombëtare dhe Evropiane të kualifikimeve. Lëndët me zgjedhje vazhdojnë të mungojnë, sikurse është evidentuar edhe në akreditimin e mëparshëm. Rëndësia e lëndëve metodologjike si dhe ngarkesa me 18 kredite e Mikrotezës së Diplomës i aftëson dhe përgatit studentët për vijueshmërinë e mëtejshëm në studime të ciklit të tretë, doktoraturës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecursisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi mbështetet në analizat e përgjithshme nga njësia bazë DSHPMN që përmbajnë aspekte të analizës së tregut të punës, të reflektuara me ndryshimet në vitin akademik 2018-2019 të këtij program studimi. Në shqyrtimin e dokumentacionit dhe bisedat me drejtuesin e departamentit përmenden se marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private i kanë mundësuar departamentit të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca që krijohen dhe ndryshojnë herë pas here. Departamenti organizon në kuadrin e aktiviteteve institucionale aktivitete të përbashkëta me partnerët si lektorë të ftuar, apo me përfaqësues të pushtetit qendror (drejtoria e Arkivave, etj.) e vendor (bashkia Tiranë, Kamëz, Kurbin, etj.) ku zhvillohen praktikatat e studentëve, apo OSHC dhe biznese private. <i>Evidenca 15. Analiza e tregut të punës.</i> <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH;</i> <i>Evidenca 8. Lista e institucioneve për praktikën 2022-2023.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për	GVJ pas takimeve në institucion me stafin e departamentit, zyrat e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe ajo e sigurimit të Cilësisë, studentët gjykoi se vlerësimi i studentëve për programin e studimit konsiderohet një burim i rëndësishëm informacioni për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e këtyre opinioneve nxitet nëpërmjet strukturave të ngritura, në veçanti Njësia e Cilësisë

përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	(NJSBCZHK) dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Zyra e Alumnit e institucionit mban kontakte me studentët e diplomuar përmes aktiviteteve periodike dhe përcjell propozimet në njësinë bazë DSHPMN. https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Për programin e studimit DSHPMN ka kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore që t'i përgjigjet kërkesave dhe nevojave për përshtatjen e programit që t'i përgjigjet nevojave nga institucionet publike e private në nivel qëndror e lokal, në fushat e ekspertizës që mbulon ky program. Praktikë konkrete është riorganizimi i këtij programi studimi 5 vjet më parë, nga Master Shkencor në Shkenca Politike (Vendim Senati të UMSH Nr. 482, datë 03.10.2011) në Master i Shkencave "Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit" ka një evoluim prej mëse 10 vjetësh. <i>Evidencë 5. Pani Strategjik i Zhvillimit të masterit shkencor</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson shkallën e përmbushjes së standardit plotësisht referuar riorganizimit të këtij programi studimi në vitin akademik 2018-2019. Në shqyrtimin e dokumentacionit dhe bisedat me drejtuesin e departamentit e studentët dalin në pah marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private, të cilat i kanë mundësuar departamentit të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca dhe aftësi bashkëkohore. Ekziston një kornizë për përfshirjen e studentëve në nivele të ndryshme të punës së institucionit, duke përfshirë edhe këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat	GVJ gjykon se objektivat dhe Pani Strategjik i Zhvillimit të këtij programi Masteri Shkencor janë në përshtatje të plotë me planin e zhvillimit strategjik të UMSH dhe të FDSHH sikurse reflektohet në

kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	dokumentacionin referues dhe nga bisedat me drejtuesit e institucionit dhe stafin akademik. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet në përputhje me misionin dhe qëllimin e UMSH, aftësimin dhe edukimin e profesionistëve të ardhshëm të politikës ekonomike me njohuri bashkëkohore që t'i përgjigjen kushteve të reja të zhvillimit të kontekstit kombëtar, rajonal e global. <i>Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	GVJ nga bisedat me stafet drejtuese të FDSHH dhe DSHPMN vlerëson se ata inkurajojnë stafin që të angazhohet, jo vetëm në aktivitetet e mësimdhënies, por edhe në aktivitetet me karakter shkencor, social, kulturor. Njësia bazë, në bashkëpunim me njësitë të IAL-së, garantojnë dhe mundësojnë bashkërendimin e veprimtarisë akademike të personelit, duke u bazuar në parimet dhe praktikën më të mira të arsimit evropian. Autonomia akademike konsiston në alternimin e formave të ndryshme në mësimdhënie, si: leksione të hapura nga lektorë të huaj/vendas, përfaqësues biznesesh ose institucione; vizita mësimore pranë bizneseve/institucioneve. <i>Evidence nr 11. Listë e Aktiviteteve të UMSH-së.</i> https://www.umsh.edu.al/c/146/te-reja
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	GVJ pas takimeve në institucion me stafin e departamentit dhe studentët vlerëson se programi i studimit mundëson përgatitjen nga ana e studentëve të detyrave të kursit ose projekteve të cilat prezantohen gjatë orëve të leksionit në auditor. Programi i studimit mundëson dhe nxit studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. Praktikë e mirë ka qenë organizimi i konferencave akademike për studentët ku studentët e programit të studimit patën mundësi të prezantojnë hulumtimet e tyre. Gjithashtu, studentët bëhen pjesë e vizitave studimore dhe kërkimore pranë institucioneve të caktuara në përputhje me tematikën e lëndës, organizuar këto nga stafi i DSHPMN. Po ashtu, finalizimi i temave të diplomave me supervizimin e profesorëve të departamentit, përbën një tregues të angazhimit dhe mbështetjes së studentëve për kërkimin shkencor. <i>Evidenca nr 39. Thirrja e Konferencës Studentore.</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore,	Për kërkimin shkencor, institucioni ofron lloje të ndryshme stimuluesh për stafin akademik që të përfshihen në kërkimin shkencor dhe në aktivitete të ndryshme studimore. Sikurse u evidentua gjatë bisedës

njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	me stafin akademik dhe e shpallur ne faqen online të UMSH, ata ishin pjesë e një projekti COST të BE dhe po organizonin në UMSH një aktivitet shkencor me pjesëmarrjen e universiteteve evropiane pjesë e atij projekti që kishte lidhje me barazinë gjinore në kërkimin shkencor në IAL. Kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet fondit institucional për financimin e publikimeve në revista ndërkombëtare. Megjithatë, financimi nuk është shpërblim për kërkimin si të tillë, por rimbursim i kostove për pagesën e tarifës për botimin e një artikulli në revistë. UMSH inkurajon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet financimit edhe të teksteve universitare. Referuar RVB, Njësia kryesore ka fituar gjatë vitit të kaluar akademik dy projekte kërkimore të financuara nga AKKSHI, duke krijuar mundësi reale për anagazhime konkrete të personelit akademik në studime konkrete si dhe përfshirjen në to të studentëve (RVB, faqe 16). https://www.umsh.edu.al/media/65096fdbf05d9.pdf https://www.umsh.edu.al/media/652675bac4cdf.pdf https://www.umsh.edu.al/c/74/konferenca-shkencore https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor si për stafet akademike edhe studentët e këtij masteri shkencor. Kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet fondit institucional për financimin e publikimeve në revista ndërkombëtare. Megjithatë, financimi nuk është shpërblim për kërkimin si të tillë, por rimbursim i kostove për pagesën e tarifës për botimin e një artikulli në revistë. UMSH inkurajon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet financimit të teksteve universitare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	FDSHH dhe DSHPMN mbështesin dhe inkurajojnë bashkëpunimet duke organizuar aktivitete kërkimore-shkencore si konferenca, workshop-e ose seminare, së fundmi konferencë ndërkombëtare në kuadrin e projektit të BE COST për barazinë gjinore në kërkim shkencor që koordinohet nga G.H., staff efektiv i Departamentit dhe këtij programi Master. Po ashtu, gjatë bisedës me stafin akademik, GVJ konfirmon se Departamenti dhe njësitë përgjegjëse japin hapësirë për angazhim në kërkime shkencore nëpërmjet financimit konkretisht të stafit që fitonte projekte post-doktorale si në rastet Gjermani, Greqi, etj., duke u paguar paga gjatë kohës së qëndrimit jashtë shtetit, për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. <i>Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësitë përgjegjëse si Departamenti dhe njësia e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë informojnë stafin akademik dhe studentët për thirrjet dhe kërkesat për kryerjen e studimeve dhe analizave dhe i inkurajon ata të aplikojnë. Konkretisht ka pjesëmarrje aktive në projektet Erasmus si nga stafet akademike edhe studentët me mobilitete (në Krakov, Poloni). Këto anagzhime institucionale reflektohen sin ë dokumentet strategjike të UMSH, FDSHH dhe DSHPMN, sikurse edhe në partneritet me aktorët e tjerë duke ofruar shërbime në fushat respektive të ekspertizës. <i>Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH.</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Nga shqyrtimi i faqes online të UMSH dhe takimet në institucion me stafet akademike e studentët, rezulton se FDSHH dhe DSHPMN organizojnë një sërë aktiviteteve me karakter shkencor dhe mësimor, duke inkurajuar stafin dhe studentët të bëhen pjesë e tyre. Përfshirja e tyre në programet e BE si COST, Erasmus dhe konferencat e ndryshme, lektorët e ftuar si personalitete të ndryshme politike, aftësojnë me tej personelin në drejtim të mësimdhënies dhe rritjen e aktiviteteve kërkimore. <i>Evidenca 17. Leksione të hapura DPSHPMN.</i> https://www.umsh.edu.al/d/199/leksion-i-hapur-shqiperia-dhe-politika-e-saj-e-jashtme-ne-kontekstin-evropian-dhe-mesdhetar https://www.umsh.edu.al/d/207/loja-leksion-i-hapur-nga-eljan-tanini



Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara përmes zhvillimit të njohurive bashkëkohore në shkencat politike dhe ekonomike nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit akademik. Kontributi i tij specifik i këtij programi të ndryshuar ka qenë përgjigja e saj ndaj kërkesës në rritje për njohuri politike dhe ekonomike të integruara si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat, ku kanë pasur mundësi edhe punësimi i studenteve.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk aplikohet
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk aplikohet
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UMSH, FDSHH dhe DSHPMN kanë reflektuar në dokumentet strategjike dhe kanë aplikuar mbështetje për ofrimin e njohurive të thelluara përmes zëvendësimit të programit të mëparshëm të masterit, kanë inkurajuar ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. Këto janë realizuar si duke organizuar aktivitete kërkimore-shkencore si konferenca, workshop-e ose seminare, ashtu edhe përfshirjes në projektet të BE si COST për barazinë gjinore, Erasmus në mobilitetet për stafin efektiv të Departamentit dhe të këtij programi Master, edhe për studentët. Po ashtu gjatë bisedës me stafin akademik, GVJ konfirmon se Departamenti dhe njësitë përgjegjëse japin hapësirë për financimin e stafi që fitonte grante për projekte duke u paguar paga gjatë kohës së qëndrimit</i>



	<i>jashtë shtetit, për realizimin e objektivave të programit të studimit. Programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Përveç formave tradicionale të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, orëve të hapura, praktikave profesionale, dhe punimit të diplomës, studentëve u kërkohen në bazë të lëndëve të realizojnë edhe projekte të përbashkëta e punë në grup. Fakti është se kjo mbetet në autonominë e pedagogut i cili orienton dhe organizon mësimin sipas syllabusit. Përmes projektit të tezës të masterit (mikroteza), e cila ka një numër të konsiderueshëm orësh dhe 18 kredite (ECTS), studentët kryejnë punë kërkimore të pavarur nën udhëheqjen e pedagogëve duke dëshmuar se kanë fituar aftësinë për të kryer kërkime të pavarura akademike. <i>Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane;</i> <i>Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike;</i> <i>Evidencë 9. Rregullorja e masterit;</i> <i>Evidencë 14. Plani mesimor i Masterit;</i> <i>Syllabuset;</i>



	<i>Takimet me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga takimet me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit, GVJ vlerëson se zhvillimi i orëve të leksionit bëhet nëpërmjet metodave interaktive, diskutimeve dhe ekspertëve të ftuar që e bëjnë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive. Diskutimet në orën e seminarit dhe prezantimet i japin mundësi studentit të bëjë analiza dhe të shprehë mendimin e tij në mënyrë të pavarur. Personeli akademik angazhohet që studentët me nevoja të veçanta nuk do të jenë subjekt i asnjë forme diskriminimi. <i>Syllabuset;</i> <i>Takimet me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	UMSH mundëson përmirësimin e kompetencave pedagogjike të stafit akademik përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme, si dhe auditorët janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, të cilat lehtësojnë përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. Në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, personeli akademik i programit të studimit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh në universitetet partnere evropiane si Greqi e Gjermani, apo përmes programeve të shkëmbit Erasmus+ personeli akademik ka patur mundësi të japë mësim dhe të përfitojë eksperiencë në universitetet partnere. Megjithatë, ka mungesë të orientimeve të qarta e trajnimeve pedagogjike për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie dhe për këtë arsye, stafi akademik më së shumti kufizohet me mësimdhënie në leksione nga tre orëshe javore, gjë që nuk ofron ndonjë fleksibilitet të madh për përdorimin e metodave innovative. <i>Evidencë 58. Të dhënat mbi mobilitetet;</i> <i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UMSH;</i> <i>Takimet me drejtuesit e DSHPMN, me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit, CV dhe takimet me drejtuesit e DSHPMN, me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit vlerëson se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojë akademike dhe profesionale në



koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndëve që zhvillojnë. Eksperienca brenda dhe jashtë institucionit, trajnimet e ndryshme dhe publikimet bëjnë të mundur që personeli akademik i angazhuar në programin e studimit të jetë kompetent në lëndën që zhvillon dhe në metoda didaktike që përdor. Një prej elementëve që programi inkurajon është të menduarit kritik dhe aftësimi të studentit të veprojë me autonomi në zgjidhjen e problemeve me të cilat ata përballen. Për këtë ata gjejnë mbështetje nga mësimdhënësit. Në takimin e GVJ-së me studentët e programit të studimit, studentët janë shprehur të kënaqur për hapësirën e ofruar për diskutime dhe mendim kritik. Ndërsa syllabueset mbulojnë përmbajtjen e një lënde, në shumë syllabuse të programit të studimit mungon informacioni për metodat e përdorura për qëllime të mësimdhënies. <i>Evidenca 14.3. CV e stafit akademik të programit të studimit.</i> <i>Evidenc 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti.</i> Syllabuset
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga vizita në Institucion, GVJ identifikoi nga format e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik përmes pyetsorëve të studentëve që kryhen në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatit e tyre. Mendimet e studentëve reflektohen në pyetësor i cili administrohet nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Standarteve të Cilësisë. DSHPMN nëpërmjet tyre vlerëson metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët. Rezultatet e vlerësimeve diskutohen në nivel departamenti. Sugjerimet e studentëve gjejnë vend e më pas reflektohen në programin e studimit. Gjithashtu, studentët shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre gjatë orëve të mësimi dhe në komunikimet dhe takimet e tyre me stafin akademik të departamentit, si dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Organizimi i fokus grupeve me studentët ofron mundësi shtesë të komunikimit të pikëpamjeve të studentëve në departament. <i>Evidenca 31. Procedura e punës me fokus grupet.</i> <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në	UMSH ka struktura institucionale që mbështesin përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. UMSH

nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	nëpërmjet strukturave të ngritura, në veçanti NJSBCZHK, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike Kjo njësi bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me njësitë kryesore dhe bazë dhe organizojnë trajnime për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Nisma më e fundit në këtë drejtim ka qenë organizimi i orëve me mjete online gjatë pandemisë Covid-19. NJSBCZHK dhe njësia bazë mbledhin opinione, duke përfshirë studentët në këtë proces. Kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të personelit akademik të angazhuar rishtazi, sikurse u konfirmua gjatë takimit të GVJ me stafin akademik duke vënë theksin në aspektet metodike dhe të organizimit të procesit mësimor. <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i> <i>Evidenca 29. Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues..</i> <i>Evidenca 37. Plani i punës NJSBCZHK.</i> <i>Evidenca 27. Programi i trajnimeve 2022-2023.</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH ka struktura institucionale që mbështesin përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, në veçanti NJSBCZHK. Kjo njësi bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me njësitë kryesore dhe DSHPMN dhe organizojnë trajnime për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Nisma më e fundit në këtë drejtim ka qenë organizimi i orëve me mjete online gjatë pandemisë Covid-19. Kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të personelit akademik të angazhuar rishtazi, sikurse u konfirmua gjatë takimit të GVJ me stafin akademik duke vënë theksin në aspektet metodike dhe të organizimit të procesit mësimor. NJSBCZHK dhe njësia bazë mbledhin opinione, duke përfshirë studentët në këtë proces përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
------------------------	--------------------------------------



Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret e Universitetit, të Fakultetit dhe të Departamentit përcaktojnë kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive. Studentët njoftohen mbi këtë gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Format e vlerësimit i komunikohen studentëve nga pedagogët dhe janë të përshkruara edhe në syllabuset e lëndëve. <i>Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 22 . Udhëzues për studentët</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të lëndës për çdo semestër, titullari i lëndës i njeh studentët me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve. Vlerësimi i njohurive bëhet me pikë nga (0-100), që konvertohen në notë (4-10). <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 22. Udhëzues për studentët.</i> <i>Evidenca 23. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ nga biseda me studentët rezulton se për studentët e programit të studimit MND në pjesën dërrmuese përdoret forma e kontrollit të dijes të provimit me shkrim me alternativa si dhe komponentët e tjerë plotësues si pjesmarrja, detyrat e kursit dhe projektet. Komponenti më i rëndësishëm i vlerësimit mbetet provimi me shkrim, kryesisht me pyetje me alternative. <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 22. Udhëzues për studentët.</i> <i>Evidenca 23. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>
Konkluzione	GVJ konkludon se Rregulloret e Universitetit, të Fakultetit dhe të Departamentit të Shkencave Politike e Marrëdhënieve Ndërkombëtare përcaktojnë kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive. Studentët njoftohen mbi këtë gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Format e



	<i>vlerësimit i komunikohen studentëve nga pedagogët dhe janë të përshkruara edhe në syllabuset e lëndëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje e notës përfundimtare. UMSH ka një strukturë që privilegjon kontrollin e vazhdueshëm të dijes gjatë vitit. Kjo reflektohet kryesisht në ndarjen e angazhimit në diskutime gjatë seminareve dhe me detyra të prezantuara përgjatë zhvillimit të lëndës, detyrave të kursit dhe provimit të kontrollit të dijes në dy periudha, atë të ndërmjetme dhe atë përfundimtare. Forma e kontrollit është me shkrim, përmes një provimi me pyetje me alternative. <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 23. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, GVJ konfirmon se UMSH ka mbështetur përdorimin e sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit, në përputhje me mundësitë e aplikimit të tyre në programet e studimit me qëllim sigurimin e origjinalitetit të përgjigjeve dhe transparencës së vlerësimit. Institucioni ka nxitur pedagogët të vënë në zbatim formatet elektronike (quiz assignment) google form, të testimit dhe vlerësimit të provimeve, duke ofruar trajnime dhe udhëzues të posëm. Disa prej tyre vazhdojnë të përdoren dhe që lidhen me vlerësimin e vazhdueshëm në platformën google classroom. <i>Evidenca 32. Manual i përdorimit të platformave elektronike.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore shqyrtoi se vlerësimi përfundimtar bëhet nga titullari i lëndës. Procedurat e vlerësimit përfundimtar të njohurive gjenden të përcaktuara në aktet rregullative të Institucionit dhe Departamentit, syllabusit të lëndëve si dhe udhëzuesin mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve

	dhe plani i punës për sezonin.. Procesverbali final mban firmën e pedagogut, shefit të departamentit, kryesekretares dhe dekanit. Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit Evidenca 8. Rregullore e DPSHPMN Evidenca 23. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Ndonëse nuk është sistematike, ata studentë që dëshirojnë të marrin komente, mund të bisedojnë me pedagogët e tyre për të kuptuar më mirë pikat e tyre të forta dhe për të identifikuar dobësitë në procesin e të mësuarit. Rregulloret përcaktojnë që tezat e provimit të kenë një seksion të veçantë ku pedagogu mund të bëjë komente për secilën pyetje. Edhe gjatë prezantimit të detyrave të kursit pedagogu bën komentet përkatëse, duke pasur në fokus jo vetëm evidentimin e pikave që studenti duhet të përmirësojë por dhe duke e stimuluar për punë dhe projekte të tjera. Evidencë 2. Rregullore e Universitetit; Evidencë 6. Rregullore e Fakultetit; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 7. Rregullorja e Programit Master.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregulloret përcaktojnë që kopjimi dhe plagjatura nuk tolerohet, provimet monitorohen nga të paktën dy pedagogë, të cilët caktohen nga departamenti. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur. Po ashtu bëhen përpjekje për të shmangur plagjiaturën kur studentët dorëzojnë projekte, ese ose teza përfunduese për diplomën master. Megjithatë, nuk del në pah përdorimi i ndonjë platforme specifike që e evidenton plagjiaturën. Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Gjatë bisedimeve të GJVJ në institucion dhe shqyrtimit të Rregulloreve pedagogët japin rezultatet e vlerësimeve të tyre brenda një afati të caktuar nga data e mbajtjes së provimit duke siguruar respektimin e vlerësimit të bazuar në merita. Po ashtu, sekretimi i provimit garanton vlerësimin objektiv të njohurive të studentit bazuar në punën e tij; korrigjimi i provimit bëhet nga pedagogët e lëndës nën drejtimin e titullarit të lëndës. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Studentit (SMS), pedagogu hedh në procesverbalin analitik (online) pikët për frekuentimin, pikët e provimit të ndërmjetëm/ detyra kursi dhe pikët e provimit përfundimtar, brenda pesë ditëve nga zhvillimi i provimit, pas korrigjimit të provimit.

	<i>Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024.</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 23. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rezultatet e kontrollit të dijes bëhen publike sikurse e përcaktojnë dhe rregulloret e institucionit. Rezultati paraprak i provimit i bëhet i ditur dukshëm studentëve nëpërmjet sistemit SMS në llogarinë personale të tyre në kohë reale. Studentët kanë të drejtë të ankohen brenda 72 orëve nga shpallja e rezultateve të provimit. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të provimit, nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim, që dorëzohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe ndiqet nga njësi përgjegjëse. Pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve përfundimtare të provimeve. <u>http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</u> <i>Ref. Evidencë 2. Rregullore e Universitetit;</i> <i>Evidencë 6. Rregullore e Fakultetit;</i> <i>Evidencë 8. Rregullore e Departamentit;</i> <i>Evidencë 7. Rregullorja e programit master.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Ekziston një procedurë ankimimi nga studenti për vlerësimin, e cila vlerësohet nga një komision i ngritur posaçërisht, procedurë që parashikohet në rregulloret e UMSH, Fakultetit dhe Departamentit. Ky komision në bazë të kërkesës procedon me ballafaqimin e testit e përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Prej vitit akademik që ky program është riorganizuar, nuk ka pasur raste konkrete. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 23. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka përcaktuar në rregullore procedura që sigurojnë vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Rezultati paraprak i provimit i bëhet i ditur studentëve nëpërmjet sistemit SMS në llogarinë personale në kohë reale. Studentët kanë të drejtë të ankohen brenda 72 orëve nga shpallja e rezultateve të provimit, nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim, që ndiqet nga njësi përgjegjëse.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Ky program studimi garanton zhvillimin e njohurive në fushën e shkencave politike dhe ekonomike referuar lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Programi i studimit i lejon studentit që të krijojë profilin e tij akademik duke i dhënë mundësi për studime të thelluar në fushat respective dhe të kryejnë në mënyrë të pavarur kërkim shkencor dhe të zhvillojnë strategji kërkimore, të thellojë njohuritë për zhvillimin e aftësive profesionale. Studentët janë gjithashtu të angazhuar në aktivitete të ndryshme kërkimore dhe shkencore që i ndihmojnë ata të thellojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre. <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i> <i>Evidencë 14. Plani mësimor Master 2022-2023;</i> <i>Syllabuset</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ pas takimit me studentët e programit të studimit vlerëson se ky program Masteri ofron zhvillimin e aftësive në fushën specifike të shkencave politike si fushë studimi e shkencave sociale. Aftësitë e veçanta orientohen kah zhvillimit të kapaciteteve analitike të studentëve dhe formimin e tyre, aftësi komunikimi, si dhe zgjeron perspektivën në fushën studimore dhe atë sociale. Ky program nuk përfshin lëndë në gjuhë të huaj. <i>Evidencë 11. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese DSHPMN</i> <i>Evidencë 14. Plani mësimor Master 2022-2023;</i> <i>Syllabuset</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton	Nga takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët doli qartë se si rregull, në përfundim të lëndës, pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu, detyra e kursit që zhvillohet nga studentët tregon aftësitë që ata kanë përfituar nga lënda. Syllabuset përmbajnë komponentë që kanë të bëjnë me qëllimin e lëndës, objektivat dhe pritshmëritë e pedagogëve mbi

studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	kompetencat dhe aftësitë që studentët duhet të përftojnë në fund të lëndës. <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i> <i>Evidencë 14. Plani mësimor Master 2022-2023;</i> <i>Syllabuset</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët doli qartë se lektorët duket se inkurajonin diskutimet në klasë dhe u japin hapësirë studentëve për të reflektuar mbi pikëpamjet dhe analizat e tyre. Bashkëpunimi i krijuar me aktorë të ndryshëm si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat u jep mundësi studentëve të vendosin kauzalitet ndërmjet të nxënës të tyre teorik në klasë me atë që vëzhgojnë në realitet. Te detyrat e lëndëve studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Një prej komponentëve të vlerësimit të studentëve është dhe puna në grup që studentët mund të zhvillojnë gjatë studimeve. Personeli akademik inkurajon punën në grup nëpërmjet hulumtimit të një rasti studimor, planifikimin dhe zbatimin e një projekti. UMSH ka traditë në zhvillimin e leksioneve të hapura me personalitete politike dhe konferencave shkencore mbi strategjitë e zhvillimit të vendit. Zhvillimi i praktikës profesionale i mundëson studentit aplikimin e njohurive teorike në praktikë dhe i ofron atij një mundësi për lidhje me tregun e punës. Ndërkohë që ka ndërlidhje mes lëndëve dhe praktikës profesionale, kjo e fundit po zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve, gjë që nuk lejon reflektime të mëtejshme mbi rezultatet e praktikës me të nxënës në kuadër të lëndëve. <i>Evidenca 11. Leksione të hapura DPSHPMN.</i> https://www.umsh.edu.al/d/199/leksion-i-hapur-shqiperia-dhe-politika-e-saj-e-jashtme-ne-kontekstin-evropian-dhe-mesdhetar https://www.umsh.edu.al/d/207/loja-leksion-i-hapur-nga-eljan-tanini <i>Ref. Syllabuset e lëndëve.</i> <i>Evidencë 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë	GVJ referuar takimeve me stafin akademik dhe faqes online të UMSH konfirmon se stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura për të informuar kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit të disiplinave dhe fushave të tyre të studimit. Gjithashtu, konferenca shkencore dhe aktivitete jashtë kurrikulare organizohen që janë të hapura për studentët. Në

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	fillim viti akademik hartohet plani i aktiviteteve/ leksioneve të hapura, me angazhimin e personelit akademik të departamentit dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera të UMSH. Personeli akademik i departamenteve ka trajtuar tema mbi të rejtat më të fundit të shkencës e teknologjisë, që janë një tjetër praktikë, ku gjatë prezantimeve të ndryshme që behen nga personeli akademik, ftohen të marrin pjesë edhe studentët. UMSH ka ftuar personalitete për të mbajtur leksione të hapura për çështje bashkëkohore që prekin jetën e vendit dhe tema me interes për studentët. <i>Evidenca 11. Leksione të hapura DPSHPMN.</i> <u>https://www.umsh.edu.al/d/199/leksion-i-hapur-shqiperia-dhe-politika-e-saj-e-jashtme-ne-kontekstin-evropian-dhe-mesdhetar</u>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Njësia bazë organizon aktivitete të veçanta si vizita studimore pranë institucioneve të ndryshme apo përfshirjen në projekte të studentëve. Personeli akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore në kuadër të projekteve apo grupeve kërkimore të organizuara në nivel Departamenti. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit dhe tezës së diplomës si një punim origjinal si një detyrim i programit të Masterit Shkencor, i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. Në këto studime që ata kryejnë, mbështeten gjerësisht nga personeli akademik i angazhuar në programin e studimit. Studentët marrin pjesë edhe në projektet apo marrëveshjet e shkëmbimit Erasmus +. Evidenca 9. Thirrje e konferencës studentore.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit i lejon studentit mundësi për studime të thelluar në fushat respektive dhe për zhvillimin e aftësitë profesionale dhe të veçanta referuar syllabuseve të lëndëve dhe aftësive të stafit akademik. GVJ konkludon se programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese tek studentët me përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore në kuadër të projekteve apo grupeve kërkimore të organizuara në nivel Departamenti, me kryerjen e detyrave të kursit dhe tezës së diplomës si një punim origjinal si një detyrim i programit të Masterit Shkencor, që i ka mundësuar të kryejnë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. Studentët marrin pjesë edhe në projektet apo marrëveshjet e shkëmbimit Erasmus + dhe kompetencat e tyre profesionale i manifestojnë në konferencat studentore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



				X
--	--	--	--	---

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse si <i>Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>. Procedura dhe rezultatet bëhen publike për studentët. Punimi i diplomës është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë 11. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese DSHPMN</i> <i>Evidencë 21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.</i> https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti ka hartuar një paketë me udhëzime për mikrotezën dhe sipas Rregullores i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit që u konfirmuan gjatë bisedës me studentët në UMSH. Departamenti publikon listën e temave dhe pedagogët përkatës. Sipas kësaj çdo student zgjedh temën me interes dhe ndiqet nga pedagogu përkatës, i cili përzgjidhet nga studentët ose caktohet kryesisht nga Departamenti. Studenti udhëhiqet nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit të fushës që ka zgjedhur studentit. Studenti asistohet përmes takimeve të drejtpërdrejta, komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë 11. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese DSHPMN</i> <i>Evidencë 21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.</i> https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike,	Studentët e programit të studimit Master Shkencor realizojnë mbrojtjen e diplomës vetëm përmes tezës së diplomës ku natyrisht pasqyrohen njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i>

duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë 21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.</i> https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët propozojnë pedagogun dhe temën që duan të zhvillojnë në përputhje me interesat e tyre. Studentit i ofrohet nga departamenti një paketë orientuese mbi procedurën, stilin dhe mënyrën e paraqitjes së temës. Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët përgjatë 15 javëve të punimit, kryesisht semestrin e dytë të vitit të dytë. Nga biseda me studentët ata ende nuk i kishin përcaktuar temat e diplomave, por ishin të kënaqur me disponibilitetin e pedagogëve të tyre. Nga ana tjetër, stafi akademik gjatë takimit në institucion manifestoi kompetenca në fushat respektive të shkencave politike dhe aftësi të mira komunikimi me studentët, bazuar në përvojat me të diplomuarit e viteve të mëparshme. <i>Evidencë 21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.</i> https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve laboratorë mësimorë-kërkimorë, biblioteka dhe mjedise të përshtatshme ku ata i përdorin për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, zhvillimin e projekteve mësimore dhe projekteve kërkimore. Në mënyrë specifike mbikëqyrësit dhe drejtuesi i departamentit, i ndihmojnë studentët të kenë akses në institucione të ndryshme, veçanërisht kur ka nevojë për kryerjen e anketave apo mbledhjen e informacioneve kërkimore.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi bëhet me notë nga komisioni pas mbrojtjes së diplomës. Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos komisioni vlerësues. Studenti paraqet punën përmes një prezantimi për një sasi kohe të caktuar. Në bazë të performancës komisioni vendos për notën, teza ka 18 kredite dhe vlerësohet me notë bazuar në vlerësimin e udhëheqësit, oponentit, dhe tre anëtarëve të komisionit para të cilit bëhet prezantimi i tezës. <i>Evidencë 21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës.</i> https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga	Institucioni ka të përfunduar në rregulloret e tij që në përfundim të shlyerjeve akademike, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratura nga ministria përgjegjëse për arsimin. Me kërkesë të vetë studentit, ai mund të marrë një kopje

ministra përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	zyrtare të sylabuseve të programit të studimit të zhvilluar. Procedurat e lëshimit të diplomës përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, bazuar në rregulloret dhe procedurat institucionale. Suplementi i diplomës përmban të gjithë elementët e programit të studimit. <i>Evidenca 40.41. Modeli i diplomës për programin e studimit.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<i>GVJ gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore konstatoi se institucioni ruan dokumentacionin dhe i përgjigjet studentëve kur këta e kanë të nevojshme duke i vënë në dispozicion informacionet e nevojshme. Studentët pajisen me dokumentat përkatëse sikurse parashikon ligji. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve i cili siguron mbrojtjen e nevojshme të të dhënave përkatëse. Pas mbylljes së studimeve, dosja e studentit arkivohet duke respektuar legjislacionin në fuqi për arkivat.</i> <i>Evidenca 48. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm për punimin e diplomës, me disponibilitetin dhe ekspertizën e stafit akademik dhe mundësitë e bashkëpunimeve me aktorët e jashtëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfatimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të	Nuk aplikohet.

Maso



përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.				
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet.			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet.			
Konkluzione	Standardi nuk aplikohet për këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Masa


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																																		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ bazuar në shqyrtimin e dosjeve të personelit dhe bisedës me ta vlerëson se personeli akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Shkencor të Departamentit të Shkencave Politike e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Depart. Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare <table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2020 - 2021</th><th colspan="2">2021 - 2022</th><th colspan="2">2022 - 2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>0</td><td></td><td>0</td><td></td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>1</td><td></td><td>2</td><td></td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>6</td><td>1</td><td>5</td><td>1</td><td>6</td><td>4</td></tr><tr><td>Msc</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>2</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Në total</td><td>9</td><td>2</td><td>9</td><td>3</td><td>11</td><td>5</td></tr></table> <i>(Evidenca 16. Përmbledhje e Tabelave për programin e studimit MSc SPSEZH Tabela 1-Tabela 2)</i> Stafi i angazhuar për programin e studimit ka një nivel kualifikimi më të lartë se cikli i studimeve ku angazhohen në mësimdhënie për dy vitet akademike për të cilat ka evidenca si më poshtë vijon: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2021 - 2022</th><th colspan="2">2022 - 2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td></td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>1</td><td></td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>6</td><td>1</td><td>5</td><td>2</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Në total</td><td>8</td><td>1</td><td>7</td><td>2</td></tr></table> <i>(Evidenca 16. Viti 2021-2022; Dokumente shtese: viti 2022-2023)</i> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një eksperiencë disavejeçare edhe në fushën kërkimore siç vërtetohet edhe nga botimet, grupe kërkimore e shkencore sipas fushave specifike që mbulojnë.	Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	0		0		1	-	Prof.As.Dr	1		2		2	-	Dr/PhD	6	1	5	1	6	4	Msc	2	1	2	2	2	1	Në total	9	2	9	3	11	5	Tituj/grada	2021 - 2022		2022 - 2023		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1		1	-	Prof.As.Dr	1		1	-	Dr/PhD	6	1	5	2	Msc	-	-	-	-	Në total	8	1	7	2
Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023																																																																														
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																													
Prof.Dr	0		0		1	-																																																																													
Prof.As.Dr	1		2		2	-																																																																													
Dr/PhD	6	1	5	1	6	4																																																																													
Msc	2	1	2	2	2	1																																																																													
Në total	9	2	9	3	11	5																																																																													
Tituj/grada	2021 - 2022		2022 - 2023																																																																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																															
Prof.Dr	1		1	-																																																																															
Prof.As.Dr	1		1	-																																																																															
Dr/PhD	6	1	5	2																																																																															
Msc	-	-	-	-																																																																															
Në total	8	1	7	2																																																																															

	<i>Evidenca 14.3. CV e stafit akademik të programit të studimit.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit.</i> <i>Evidenca 11. Fushat e ekspertizes</i> <i>Evidenca 16. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Vlerësimi i stafit bazohet në shqyrtimin e dosjeve të personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore. Stafit akademik efektiv mbulon nga 2-3 lëndë mësimore në Departament të cilat i zhvillojnë edhe në departamente të tjera për të rritur ngarkesën mësimore. Fusha akademike e tyre është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. <i>Evidenca 14.3. CV e stafit akademik të programit të studimit.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e Programit të Studimit.</i> <i>Evidenca 11. Fushat e ekspertizes</i> <i>Evidenca 16. Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ në takimin me burimet njerëzore dhe bisedën me stafin akademik efektiv dhe me kontratë në UMSH konstatoi se personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij program studimi kanë një angazhim disavjeçar në kurset përkatëse, dhe drejtuesi i Departamentit ka përvojë të gjatë drejtuese duke kaluar shkallët e karrierës e së fundmi fiton titullin profesor. Po në karrierë në ngjitje kanë qenë edhe pjesa tjetër e stafit akademik që tregon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. GVJ verifikoi kontratat mbi marrëdhëniet e punësimit në UMSH, sikurse përcaktohet në rregullohet e UMSH. Nëpërmjet kontratës së punësimit personeli akademik i angazhuar mbulohet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. <i>Evidenca 43: Kontrata e Punës tip PAE/PAK.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Takimi i GVJ me stafin akademik provoi se ata janë titullarë të moduleve, lëndëve në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre dhe përmbajtjen e programit të studimit, dhe të rekrutuar sipas Rregulloreve të UMSH dhe Statutit të UMSH. Mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga institucioni, shpallet konkurs i hapur për vendet të lira të punës për personel akademik dhe kryhet publikimi në faqen online të UMSH, rrjete sociale zyrtare të UMSH dhe në portale të tjera të punësimit. Nga takimi i GVJ me njësinë e Burimeve Njerëzore në UMSH na u vunë në dispozicion CV akademike dhe kontratat e punës, si dhe procedurat standard të

përmbajtjen e programit të studimit.	rekrutimi dhe vlerësimit të stafit akademik. GVJ gjykon se UMSH mbështetet në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit, procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe jo efektiv në përputhje me aktet ligjore. <i>Evidenca 2. Rregullore e UMSH.</i> <i>Evidenca 38. Përmbledhje e procedurës së rekrutimit.</i> https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise https://www.umsh.edu.al/d/277/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në UMSH konstatoi se personeli ndihmës akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit sipas përcaktimeve të Rregullores së programit të studimit dhe përmbushin me korrektësi dhe etikë detyrimet e tyre. Për natyrën e programit të studimit Master shkencor, për realizimin e tij nuk ka nevojë për orë laboratorike apo për mjedise të tjera specifike mësimore. Laboratorët, sallat e leksionit dhe mjediset e tjera të mësimdhënies janë të pajisura me infrastrukturë moderne dhe pajisje teknologjike të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe objektivave formues të programit të studimit. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ gjatë vizitës në UMSH e takimit me Zyrën e Burimeve Njerëzore konstatoi se statistikën mbledhen dhe përpunohen periodikisht çdo vit akademik. ZBNJ përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit dhe i ruan në dosjet individuale të të gjithë personelit. Institucioni i raporton në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në formë elektronike dhe në letër këto të dhëna që përfshijnë statistikën mbi personelin akademik efektiv dhe jo-efektiv, ndihmës-akademik me kohë të plotë e të pjesshme, personelin akademik sipas titujve dhe gradave, statistika mbi ngarkesën mësimore të personelit akademik, etj.

Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UMSH, Fakulteti i FDSHH dhe Departamenti i DSHPMN kanë marrëveshje me IAL dhe organizata publike dhe kompani biznesi dhe nënshkruajnë në mënyrë të vazhdueshme marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, biznese dhe organizata të shoqërisë civile për praktikën profesionale të studentëve. Në Rregulloren e Praktikës Mësimore përcaktohen strukturat përgjegjëse të praktikës mësimore dhe procesi i zhvillimit të praktikës mësimore. Gjithashtu bazuar në projektet e stafit akademik, ato u shprehen gjate takimit me GVJ se bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore dhe OSHC ka qenë i frutshëm. <i>Evidenca 13. Udhëzim për praktikat dhe formularët tip të praktikës</i> <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Rregullorja e praktikës mësimore përcakton procesin e zhvillimit të praktikës mësimore për studentët e programit Master, ku personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve. Për programet shkencore të ciklit të dytë, një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësimin të studentëve për të realizuar, jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik si dhe të aftësive kërkimore të tyre. Një pjesë e studentëve e zhvillojnë praktikën profesionale si pjesë e projekteve ku njësitë bazë marrin pjesë, që i përgatisin studentët për zhvillimin e punëve kërkimore dhe shkrimin e punimeve shkencore. <i>Evidenca 13. Udhëzim për praktikat dhe Formularët e praktikës mësimore.</i> <i>Evidenca Nr.10 Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i>
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se personeli akademik që mbulon programin e studimit përmbush plotësisht standardet e cilësisë dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e një mësimdhënie bashkëkohore dhe të kërkimit shkencor sipas fushave të programit të studimit. Personeli akademik mbështetet nga stafi ndihmës dhe mjedise bashkëkohore që garantojnë mësimdhënie që përmbush standardet e cilësisë. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH sigurojnë personelin mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në përputhje me fushën e programit të studimit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vizitoi mjediset e UMSH dhe vlerëson se ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit në auditore në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program Masteri. UMSH plotëson normativën e sipërfaqes dhe vëllimit të shfrytëzueshëm për student, plotëson normativat e ndriçimit natyral, siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën dhe përmbush kërkesat për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit. <i>Evidenca 44. Urdhër për Higjenën dhe zjarrin.</i> <i>Evidenca 45. Material për bibliotekën</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ gjatë vizitës në mjediset ku zhvillohej mësimi nga Departamenti i Shkencave Politike dhe biseda me stafin vlerëson se mjediset mësimore si sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët, bibliotekat dhe mjediset e tjera plotësojnë të gjitha kushtet për mësimdhënie dhe punë në funksion të programit të studimit. Të gjitha klasat janë të pajisura me tabela whiteboard dhe mundësi për videoprojektor të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Ato lehtësojnë aplikimin e metodave të interaktive në auditor, ndërveprimin me studentët duke lehtësuar zbatimin e programit. https://usia.al/u-sia-laboratory-inauguration-at-the-mediterranean-university-of-albania-mua/
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të	GVJ konfirmon sikurse edhe më sipër se DSHPMN disponon një laborator të pajisur me mjete të teknologjisë për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të programit të studimit, si dhe hulumtimit individual të studentëve. UMSH siguron së paku laboratorë të teknologjisë së informacionit, ku përveç aktivitetit mësimor, për të aplikuar njohuritë e tyre përkatëse, departamenti organizon aktivitete ekstrakurrikulare si konferencat studentore ku

Maso



moduleve, aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	prezantohen punime të realizuara nga studentët në projektet e kurseve duke përmbushur objektivat formues të programit të studimit në tërësi.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë/ atelie specifike.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Nuk aplikohet			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se UMSH disponon një infrastrukturë me mjedise mësimore dhe pajisjet e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit. Për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së këtij programi Masteri janë nënshkruar një sërë marrëveshjes me institucione publike, biznese dhe OSHC.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

51

Masa


Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Pas shqyrtimit të syllabuseve dhe diskutimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se të gjitha lëndët e programit të studimit të ciklit dytë kanë nevojë për literatura bashkëkohore që të ndodhen fizikisht në bibliotekën e ndodhur në kampusin e ri. Nga biseda me bibliotekaren dhe shqyrtimi i fondit të librave fizike në bibliotekë, konstatuam se në vitet e fundit nuk është shtuar fondi i teksteve dhe librave fizike. Aty kishte dispenca në trajtën e leksioneve të printuara nga titullarët e lëndëve, të miratuara në Departament. Përveç kësaj literature fizike, është edhe Biblioteka elektronike e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë që mund të shfrytëzohet në sallat e bibliotekës. Një numër i konsiderueshëm i materialeve në bibliotekën e UMSH janë të fushës ekonomike, që i pershtaten edhe programit të studimit Master. <i>Evidenca 45. Material per bibliotekën.</i> http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php RVB Faqe 43.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti për programet e tij paraqet kërkesat për shtimin e librave në bibliotekë dhe propozon çdo vit literatura sipas syllabuseve të programit të studimit, ndonëse vitet e fundit sidomos pas COVID 19 janë fokusuar më tepër në literaturat online dhe jo pasurimit të bibliotekës me libra fizike. Një pjesë e titujve të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës janë botime të personelit akademik të UMSH, si tekste mësimore të fushës ekonomike dhe libra të tjerë botime të UMSH Press. Në një kërkesë për libra nga DSHPMN, ka pasaktësira ku tekstit shqip i referohet perkthyes? <i>(Evidenca46. Kërkesë për libra DSHPMN).</i> <i>Evidenca 45. Material per bibliotekën.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UMSH vë në dispozicion të studentëve bibliotekën elektronike e cila tashmë është pjesë e Electronic Information for Libraries. Biblioteka mundëson ambiente të cilat mund të shfrytëzohen lehtësisht nga numri relativisht i vogël i studentëve të programit të studimit si edhe garanton akses të barabartë.



Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	UMSH ndonëse ka një fond të kufizuar librash fizike për programin e studimit, është pjesë e EIFL (Electronic Information for Libraries) për përdorimin e platformës elektronike Edward Elgar Publishing. Platforma është e aksesueshme për studentët edhe stafin akademik brenda ambienteve të Universitetit. Kjo platformë elektronike (Edward Elgar Publishing), ofron libra dhe revista elektronike për të gjitha programet e studimit në UMSH. Biblioteka e Universitetit Mesdhetar, është bërë anëtare e COBISS me të drejta të plota në 01.02.2022 për bashkëpunimin, zhvillimin ndërkombëtar në ndërtimin e sistemeve kombëtare bibliotekare të informacionit e të sistemeve të informacionit për veprimtarinë kërkimore. <i>Evidenca 45. Material per bibliotekën</i> https://www.elgaronline.com/browse?access=user&level=parent https://al.cobiss.net/ http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Sikurse u përshkrua më sipër, institucioni i ka krijuar kushtet për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë të bibliotekës elektronike, si për studentët edhe stafin akademik brenda ambienteve të Universitetit. GVJ gjatë vizitës në Bibliotekë konstatoi se ajo është e pajisur me pajisje teknologjike që mundësojnë dhe shpejtojnë kërkimin e shpejtë të literaturës fizike e digjitale.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga biseda me studentët, rezultoi që edhe ata e preferonin literaturën online në formatin elektronik, si artikuj e libra sipas lëndëve dhe orientimit të pedagogëve. Biblioteka e ndodhur në katin zero që GVJ vizitoi kishte vende qëndrimi mjaftueshëm për numrin e studentëve të këtij programi masteri, dhe po ashtu laboratorët me kompjutera në katet e mësipërme mund t'i përdornin studentët për aksesimin e Bibliotekës online si Cobiss.al.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të	Biblioteka plotëson nevojat e studentëve për literaturë bazë dhe ndihmëse duke ofruar edhe versionin on-line në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët. Aksesimi i Bibliotekës sigurohet në orare të përshtatshme me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe sipas nevojave të studentëve, sikurse u konfirmua nga biseda me bibliotekaren dhe studentët e këtij programi studimi. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në faqen online të universitetit.

studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Në UMSH dhe DSHPMN vazhdon traditën me planifikimin vjetor për blerjen e literaturave bashkëkohore për realizimin e programit të studimit për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës, ndonëse vitet e fundit nuk ka pasur shtim të librave fizikë në shkenca politike, pasi vëmendja ka qenë në mundësimin e bibliotekave online. Çdo student dhe lektor ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave për burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik. Me shfrytëzimin e sistemeve open access, biblioteka e Universitetit ka siguruar përditësimin dhe rritur shkallën e shfrytëzimit të fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, POLITEIA është një revistë shkencore e cila publikon peer reviewed artikuj në shqip ose në anglisht në fushën e shkencave juridike, sociale, politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave humane. Revista publikohet dy herë në vit nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Revista ofron një hapësirë ku studiuesit të publikojnë punën e tyre kërkimore shkencore duke ruajtur standardet më të larta të kontrollit të cilësisë. <i>Evidenca 45. Material per bibliotekën.</i> https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press https://www.umsh.edu.al/media/64905ffcbb78b.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Politike e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ndonëse referon një literaturë të pasur tek studentët për të realizuar programin e studimit, duhet të shtojë literaturën e nevojshme fizike të përditësuar në bibliotekën e tij në mbështetje të mësimdhënies. Mundësitë me literaturat online janë të pëlqyeshme, si për stafet akademike edhe për studentët e Masterit Shkencor. Aksesit në to është i njëjtë për të gjithë në mjediset e brendshme të UMSH.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të një sërë dokumentesh, GVJ vlerëson se strukturat akademike dhe ndihmës akademike në UMSH, nga sekretaritë deri tek Departamenti sigurojnë administrimin e gjithë informacionit në lidhje me studentët, nga regjistrimi për studentët e rinj, informimi në mënyrë të vazhdueshme për oraret, lëndët, provimet, mundësitë që ata kanë për trajnime, mobilitete apo praktika profesionale gjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre, deri në diplomim. GVJ shqyrtoi nëpër regjistrat standard një bazë të dhënash të plota e të përditësuara mbi studentët të tilla si: gjeneralitetet, programi i studimit që ndjekin, data/viti i rregjistrimit për programin e studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datë çrregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), dhe datën e diplomimit. Institucioni ka realizuar informatizimin e tij në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor e shkencor. http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Evidenca 32. <i>Manual i përdorimit të platformave elektronike</i> Evidenca 48. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Gjatë vizitës në UMSH, Struktura e Burimeve Njerëzore i vuri në dispozicion GVJ bazën e të dhënave që përmbante informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Shkencor. Sistemi i menaxhimit të informacionit në formë elektronike përmes faqes zyrtare të UMSH lehtëson kryerjen e këtyre proceseve. Përsa i takon regjistrave të lëndëve dhe procesverbalet e provimeve, ato administrohen nga Sekretaria Mësimore. http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Evidenca 32. <i>Manual i përdorimit të platformave elektronike</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në UMSH, GVJ bëri kërkesën për aksesin në dokumente dhe informacione për persona të caktuar nga stafi akademik me zgjedhje rastësore dhe sektori i Burimeve Njerëzore u përgjigj pa hezitim; po ashtu sekretaria mësimore na siguroi të dhëna të dedikuara për disa studentë të Masterit Shkencor. Pjesa e dedikuar për studentët ju mundëson atyre informimin dhe komunikimin mbi aktivitetet mësimore, rregulloret, udhëzimet dhe të dhëna të tjera për programin, i gjithë ky sistem është i aksesueshëm edhe nga jashtë institucionit si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët. Të



	dhënat garantohen si për personelin dhe studentët në mënyrë fizike dhe virtuale nëpërmjet zonës së studentit në websitin e UMSH dhe në sistemin e përdorimit elektronik për stafin akademik, për fakultetet dhe programet e studimit që ofrohen. Në faqen zyrtare ka nevojë të përditësohen kreditet për mikrotezën nga 20 ECTS në 18 ECTS, apo të praktikës 15/12 ECTS sikurse evidentohet në linkun: https://www.umsh.edu.al/media/6530f0148a8e1.pdf të cilat nuk përputhen me Evidencën 14.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Studentëve SMSUMSH (në 2017) të organizuar në mënyrë të tillë që studenti të ketë akses në informacionet e natyres akademike dhe në atë financiare në kohë reale dhe pa pasur nevojë të kontaktojë drejtperdrejt njësitë përkatëse. Në funksion të përmirësimit të komunikimit të studentëve dhe pedagogëve, si dhe ndërmjet stafit akademik e atij ndihmës, gjatë vitit 2020 institucioni ndërtoi dhe aktivizoi edhe sisteme të tjera komunikimi, që u përdorën dhe vijojnë të përdoren me sukses në informimin e studentëve për detyrimet ndaj lëndëve të vecanta, hedhjen e leksioneve, duke ndihmuar kështu realizimin me eficiencë të procesit mësimor, organizativ dhe atë shkencor (G-Suite dhe sistemi Zoom Cloud meeting). (RVB faqe 36).
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjatë vizitës në UMSH konstatoi se Sistemi i Menaxhimit garanton informacionet mbi aktivitetet akademike e administrative në kohë reale, të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportime individuale. Drejtuesit e institucionit dhe përgjegjësi i Departamentit marrin periodikisht raportet individuale mbi prezencën e stafit në orarin e duhur, raportet individuale për kërkimin shkencor, raportet individuale për cilësinë në mësimdhënie, raportet mbi frekuentimin e studentëve sipas afatit të përcaktuar në rregulloren e programit.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja online e UMSH përmban të gjitha informacionet mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitetet, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë të përditësuara. https://www.umsh.edu.al/eng

Maso



Konkluzione	GVJ gjatë vizitës në UMSH konstatoi se Sistemi i Menaxhimit garanton informacionet mbi aktivitetet akademike e administrative në kohë reale, të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportime individuale. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Faqja online e UMSH përmban të gjitha informacionet mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze, ndonëse ka nevojë të përditësojë informacionet mbi programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ referuar dokumenteve kryesore të UMSH si Statuti e Rregullore dhe pas vizitës në institucion konfirmon se UMSH rregullisht përpilon raportin financiar për kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. Plani hartohet nga Departamenti duke marrë në konsideratë realizimin e objektivave të programit të studimit, kërkesave të stafit dhe studentëve. Pastaj planifikimi kalon në njësitë përgjatë linjës hierakike, duke mbërritur për miratim në Bordin e Administrimit. Administratori i UMSH mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, harton çdo vit projekt buxhetin vjetor dhe propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit. Bordi i Administrimit brenda muajit dhjetor miraton buxhetin që përfshin vitin e ri akademik. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH.</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit të UMSH.</i> <i>Evidenca 19.1 Tabela e Raportit Financiar.</i> <i>Evidenca 19.2 Pasqyrat Financiare.</i> <i>Evidenca 19.3 Raporti i Auditit.</i>

Masa


Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase	Nga evidencat e shqyrtuara gjatë vizitës në institucion dhe ato në faqen online të ASCAL, GVJ konfirmon se Plani financiar mban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orët mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, kualifikimeve afatshkurtra dhe afatmesme, brenda dhe jashtë vendit, projektet, aktivitete shkencore e shpenzimet e ndryshme operative, etj. Institucioni ka një strukturë të posaçme për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare, Zyra e Menaxhimit Financiar, e cila analizon kostot llogarit rezultatet për çdo program studimi. Plani i financimit të programit të studimit përfshihet në planin financiar të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe ky i fundit në atë të Universitetit. Burimet financiare të institucionit janë: të ardhurat nga tarifat, të ardhura nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të ardhura nga shërbimet apo të ardhura nga
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Auditimi financiar si një procedurë e përvitshme e Institucionit kryhet nga një Kompani Auditimi e çertifikuar e jashtme ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të cilat sikundër përcaktohen nga legjislacioni në fuqi janë publike. <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit të UMSH.</i> <i>Evidenca 19.2 Pasqyrat Financiare.</i> <i>Evidenca 19.3 Raporti i Auditit.</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik edhe nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. Administratori evidenton dhe korrigjon shmangiet e përkohshme që mund të ketë për zëra të veçantë të buxhetit dhe bëhen ndryshimet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH.</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit të UMSH.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet	GVJ pas shqyrtimit të pasqyrave financiare dhe raporteve që lidhen me to, si dhe raportet e auditit, konfirmon se të dhënat financiare dëshmojnë se UMSH garanton qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për zhvillimin e programit të studimit, për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktivitetit për vitet e ardhshme. Në rastet e

financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	riskut të reduktimit të numrit të studentëve, dhe për rrjedhojë edhe i të ardhurave financiare të lidhura me studentët në të ardhmen, Departamenti ka synuar diversifikimin e financimeve duke aplikuar dhe fituar disa projekte kërkimore dhe bashkëpunime me universitete evropiane. <i>Evidenca 19.1 Tabela e Raportit Financiar.</i> <i>Evidenca 19.2 Pasqyrat Financiare.</i> <i>Evidenca 19.3 Raporti i Auditit.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ referuar dokumenteve kryesore si Statuti e Rregullore të UMSH dhe pas vizitës në institucion konfirmon se UMSH rregullisht përpilon raportin financiar për kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. UMSH garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në	Nga vizita në UMSH dhe bisedat me studentët dhe stafin administrativ e drejtuesit, GVJ vlerëson se politikat dhe procedurat që shoqërojnë procesin nga hyrja në dalje të studentëve, përgjatë gjithë ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor, mbështeten në legjislacionin në fuqi, Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në

Masa

Le

fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr.436, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e ciklit të dytë". Po ashtu, edhe aktet rregullatore të institucionit të tilla si: Statuti (<i>Evidenca nr.1</i>); Rregullorja e UMSH (<i>Evidenca Nr.2</i>), Rregullorja e Fakultetit (<i>Evidenca Nr.6</i>); Rregullorja e programit të studimit (<i>Evidenca Nr.7</i>) në zbatim të ligjit konfirmojnë procedurat korrekte për kriteret e pranimiit dhe transferimit të studimeve të ciklit të dytë. Këto politika konsistojnë në informimin e plotë të studentëve në hyrje mbi programin, mësimdhënien, infrastrukturën dhe përgjatë studimeve deri në dalje sikurse janë të shprehura qartë në Planin e Zhvillimit Strategjik të UMSH, në strategjinë e zhvillimit të vet programit si dhe në rregulloret e FDSHH dhe të njësisë bazë që realizojnë këtë program studimi. Statistikat në rritje të numrit të studentëve të rregjistruar në programin e studimit nga viti akademik 2020-2021 me 42 studentë në 45 studentë në vitin e fundit akademik 2022-2023. <i>Evidenca 4. Plani i Zhvillimit Strategjik UMSH.</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit.</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> Dokumente shtesë: Nr. i të Rregjistruarve
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Kriteret dhe procedurat kryhen nëpërmjet një procesi transparent të vlerësimit dhe përzgjedhjes së aplikantëve duke respektuar kuotat e pranimiit, përfshirë këtu edhe kuota për kategori të veçanta si për studentë nga trojet, pakicat kombëtare, me status jetimi si dhe personat me aftësi të veçanta. Barazia dhe të drejtat e njëjta në hyrje dhe në dalje për të gjithë kandidatët garantohen përgjatë të gjithë ciklit të studimit bazuar në Statutin e UMSH dhe Rregulloren e Programit të Studimit, duke respektuar kuadrin ligjor. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu X, Neni 8.</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH,</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta	Gjatë vizitës në UMSH, bisedave me studentët, shqyrtimit të dokumentacionit dhe shqyrtimit të faqes online të universitetit, GJVJ gjykon se në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë

për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	80/2015, institucioni shpall kriteret specifike të pranimit për çdo vit akademik. Kriteret publikohen në faqen online të UMSH dhe në ambjentet e institucionit. Kriteret hartohen në bashkëpunim mes Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare e strukturave të ngritura në zbatim të kuadrit rregullator nga UMSH. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit https://www.umsh.edu.al/c/152/fituesit https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Gjatë vizitës në UMSH, bisedave me studentët dhe shqyrtimit të faqes online të universitetit, GVJ gjykon se aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me kriteret dhe procedurat e programit të studimit bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit dhe mjeteve të komunikimit për studentët dhe të gjithë të interesuarit. gjatë të gjithë ciklit akademik. Ato mbështeten në Statutin e UMSH-së, Rregulloren e Fakultetit FDSHH, Rregulloren e Programit të Studimit. <i>Evidenca nr.1 Statuti i UMSH;</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH,</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit.</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit https://www.umsh.edu.al/c/152/fituesit https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UMSH mundëson informimin e studentëve dhe të gjithë personave të interesuar mbi kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit, ku stafi i departamentit i orienton për programin Master. Faqja online e UMSH dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit. GVJ i konfirmoi këto gjatë takimit në institucion me stafin e departamentit dhe studentët. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës koordinon punën për informimin e studentëve duke organizuar aktivitete, orë të hapura dhe panairc me qëllim prezantimin e kriterëve për secilin program studimi. <i>Evidenca 51. Rregullore ZKSK.</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe VKM-në Nr. 39, datë 23.01.2019 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, UMSH ka hartuar dhe publikon në mënyrë të vazhdueshme kritere të qarta për studentët me aftësi ndryshe dhe ka miratuar Rregulloren për Studentët me aftësi ndryshe. Për këtë kategori studentësh në godinat e UMSH është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme për të lehtësuar lëvizjen e tyre si ashensore, të cilët i provoi edhe GVJ gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH,</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<i>Nuk aplikohet për këtë program studimi</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UMSH ka politika mbështetëse për studentët e kategorive sociale të vecanta që përfitojnë bursë të studimit, si pjesë e strategjisë së zhvillimit në të ardhmen. Çdo vit, UMSH bazuar në VKM nr. 780, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", Bordi i Administrimit, Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" u akordon bursa kategorive të ndryshme të aplikantëve që duan të kryejnë studimet në Bachelor dhe Master merr vendim mbi bursat, kategorinë dhe masën e tyre. UMSH sipas rasteve specifike dhe sipas kërkesave të studentëve në formularin e tyre të aplikimit në UMSH, alokon bursa për kategori sociale të veçanta për studentë nga shtresa dhe komunitete të marginalizuara siç janë ata romë dhe ballkano-egjiptianë, si dhe studentë me aftësi ndryshe. UMSH, në zbatim të strategjisë së zhvillimit të tij dhe vizionit të tij afatgjatë, ka diversifikuar llojet e bursave ndër vite për kategori të ndryshme të aplikantëve që duan të kryejnë studimet në Bachelor dhe Master.



	BURSA PËR PROGRAMET MASTER KATEGORIA 5 - Tarifë e reduktuar në shumën 70,000 Lekë pa TVSH a. BURSË EKSELENCE MASTER - Përfitojnë 3% e aplikantëve nga grupet në nevojë dhe me rezultate shumë të mira (familje me ndihmë ekonomike, status jetimi, fëmijë dëshmorësh, (polici, forca të armatosura) me aftësi ndryshe, komunitetet e marginalizuara, të ngjashëm, etj). - Përfitohet nëpërmjet APLIKIMIT on line në faqen e UMSH. b. KATEGORIA 6 - Tarifë e reduktuar në shumën 140,000 Lekë pa TVSH. a. BURSË PËR STUDENTË SHUMË TË MIRË MASTER- Përfitojnë deri në 1 % të gjithë studentëve të regjistruar për herë të parë në sistemin Master ku nota mesatare e studimeve bachelor është nga 9 deri në 10, dhe me kushte ekonomike jo të favorshme. - Përfitohet nëpërmjet APLIKIMIT on line në faqen e UMSH-së KATEGORIA 7 - Tarifë e reduktuar në shumën 180,000 Lekë pa TVSH a. BURSË MBËSHTETËSE do të pranohen deri në 1% e studentëve me të ardhura relativisht të ulëta, kushte specifike familjare etj, grupime që nuk përfshihen në kategoritë e tjera të këtij vendimi. - Përfitohet nëpërmjet APLIKIMIT on line në faqen e UMSH. https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat Kategoritë e bursave që ofrohen nga UMSH janë: a) bursat sociale; b) bursat e ekselencës; c) bursat e talentit dhe sportit; d) bursat mbështetëse. Vetëm për vitin akademik 2022-2023 institucioni ka akorduar bursa të plota dhe të pjesshme për 62% të studentëve, të regjistruar në të gjitha ciklet e studimit (RVB, faqe 41).
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se politikat dhe procedurat që shoqërojnë procesin nga hyrja në dalje të studentëve, përgjatë gjithë ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor, mbështeten në legjislacionin në fuqi, Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM Nr.436, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e ciklit të dytë". Po ashtu, edhe aktet rregullatore të institucionit të tilla si: Statuti, Rregullorja e UMSH, Rregullorja e Fakultetit, Rregullorja e programit të studimit në zbatim të ligjit konfirmojnë procedurat korrekte për</i>



	<i>kriteret e pranimit dhe transferimit të studimeve të ciklit të dytë. UMSH ka hartuar dhe publikon në mënyrë të vazhdueshme kritere të qarta për studentët me aftësi ndryshe si dhe shtresat e marginalizuara dhe ka miratuar Rregulloren për Studentët me aftësi ndryshe. Në faqen zyrtare të UMSH janë të publikuara edhe politikat për bursat studentore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ nga biseda me studentët konfirmon se UMSH e konkretisht DSHPMN, në bashkëpunim me strukturat e tjera të UMSH, u siguron studentëve të programit të studimit Master informacion të plotë e të hollësishëm mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik. Që javën e parë të çdo viti akademik u bëhet i njohur programi, lëndët, kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe përgjatë vitit sekretaria mësimore dhe departamenti informon studentët për orarin mësimor, frekuentimin, rezultatet e provimeve. Informacion i detajuar mbi oraret, programin, njoftimet për provime etj, jepet në SMS (sistemi i menaxhimit të studentëve), nëpërmjet faqes online të UMSH. Këto janë të specifikuara në dokumentet e brendshme të UMSH. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN</i> <i>Evidenca 22. Udhëzuesi i Studentit.</i> https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme, të plota ose të pjesshme, janë të përcaktuara në Rregulloren e UMSH, në rregulloret e programit të studimit dhe të njësive bazë e kryesore, sipas sistemit të krediteve. GVJ nga bisedat me studentët konfirmon se ata janë të informuar në lidhje me kriteret që për transferimin e studimeve, se u duhen 30 kredite minimale.

Mase


	Referuar në Programin e Transparencës, kriteret janë të kuptueshme e të aksesueshme për studentë dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare online, si edhe nëpërmjet Udhëzuesit të posaçëm për studentet. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN</i> <i>Evidenca 22. Udhëzues i studentit.</i> https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ bazuar në bisedat me stafin akademik, studentët dhe në kuadrin rregullator të UMSH konfirmon se kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive ju bëhen me dije studentëve nga lektorët e lëndëve respektive që në orën e parë mësimore; po ashtu ato janë të shpallura në broshura informative dhe katalogut studentor, si dhe në faqen online të UMSH. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN</i> <i>Evidenca 22. Udhëzues i studentit.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Sikurse u konfirmua nga bisedat e GVJ me stafin akademik në UMSH, pedagogët që supervizojnë temat e diplomave i asistojnë nga afër studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. DSHPMN mbështetur në rregulloren e programit të studimit, në listën e fushave të ekspertizës dhe temave orientuese për diplomat që ua ben me dije studentëve në muajin dhjetor të vitit akademik, si dhe udhëzuesit për përgatitjen e punimit të diplomës, informojnë studentet në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Informacioni gjendet edhe në faqen zyrtare të UMSH. <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 11. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese DSHPMN</i> <i>Evidenca 21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i> https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë	GVJ, nga bisedat me stafin dhe studentët konfirmon se në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për të gjitha detajet e programit të studimit përmes një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura për tërheqjen e kandidatëve potencialë

Masa

g

publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	për studentë të masterit. Faqja online e UMSH dhe broshura informative e programeve Master, qartësojnë kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit. https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres Evidenca 33. Broshura e programeve Master.			
Konkluzione	GVJ konfirmon se përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. UMSH u siguron studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit me rregulla të detajuara për përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim me rregulloren e provimeve e të diplomimit në këtë program të studimeve Master. Informimi bëhet përmes takimeve të organizuara me studentët, nga stafi i Departamentit dhe titullarët e lëndëve për programet respektive, nga broshurat dhe faqja online e UMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ pas bisedës me stafin e Departamentit dhe studentët konfirmon se në fillim të çdo viti akademik, Departamenti informon dhe orienton studentët mbi planin mësimor, mbi strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Kjo bëhet nga pedagogë, sekretaria mësimore, koordinatori i programeve master. Format online të informimit janë të aksesueshme në faqen zyrtare të UMSH, etj. https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Evidenca 33. Broshura e programeve Master.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve	Stafi me përvojë i Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe studentët i prezantuan GVJ

Mase



informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	gjatë vizitës në UMSH, se sa i takon kurrikulës dhe lëndëve të programit të studimit, përmbajtjes së syllabuseve dhe organizimit të veprimtarisë formuese ata janë të familjarizuar që në fillim të studimeve. Njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit i ka bërë transparente të dhënat e tyre edhe në faqen online me shpalljen e Planit Mësimor të Masterit Shkencor, i cili ka nevojë të përditësohet. <i>Evidenca 14. Plani mesimor MScSPSEZH për vitin akademik 2022-2023.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 33. Broshura e programeve Master.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi i GVJ me studentët dhe shqyrtimi i dokumnetacionit të UMSH, vlerësojmë se krahas departamentit ka një strukturë përgjegjëse që informon dhe këshillon studentët për mundësitë e praktikave mësimore, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe mbi mundësitë të punësimit. DSHPMN në bashkëpunim me koordinatoren e programeve master dhe njësitë e tjera organizative të UMSH, siç është ZKSK, ndihmon studentët e saj që të aftësohen për të aplikuar për punë, pjesëmarrje në panaire, organizime takimesh me profesionistë të fushës/ studentë alumni, trajnime për përgatitjen e CV, etj. <i>Evidenca 15. Analiza e tregut të punës</i> <i>Evidenca 49. Formulari i studentit alumni</i> <i>Evidenca 51. Rregullore e ZKSK</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Stafi i UMSH i vuri në dispozicion GVJ informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, i cili ofrohet edhe online në faqen zyrtare të UMSH. Informacioni mbi to është lehtësisht i aksesueshëm për studentët si nëpërmjet Departamentit dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit online sikurse u konfirmua gjatë bisedës së GVJ me studentët. Po ashtu GVJ vizitoi mjediset për infrastrukturën e plotë për zhvillimin e procesit mësimor në Masterin Shkencor i cili nuk kërkon ndonjë logjistikë të sofistikuar. <i>Evidenca 36. Broshura e studimeve Master.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të	GVJ gjatë vizitës në UMSH konfirmoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit mundësohet nga platformat përkatëse që u siguron studentëve informacionin e detajuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm lehtësisht kudo që ata

brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	ndodhen. Nëpërmjet faqes zyrtare online të UMSH secili student dhe pedagog ka llogarinë e tij dhe ky sistem ka të gjitha dokumentacionet në shërbim të programit të studimit, të aksesueshme lehtësisht nga studentët. http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura në përputhje të plotë me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor 80/2015 dhe me udhëzimet vjetore që dalin nga ministria për arsimin e lartë mbi kriteret e pranimit. Këto politika janë të shprehura qartë në Planin strategjik të zhvillimit të UMSH, në Strategjinë e zhvillimit të vet programit si dhe në rregulloret e njësisë bazë që realizon këtë program studimi. UMSH vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit. Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit, i lehtësuar nga platformat përkatëse, i ofron studentëve informacion të detajuar e të përditësuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm lehtësisht kudo që ata ndodhen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UMSH respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në Ministrinë e Arsimit të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve. GVJ e konfirmon këtë pas shqyrtimit të evidencave të vena në dispozicion nga Sekretaria Mësimore. Kjo zyrë ka përgjegjësinë të mbledh të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar në programin e studimit. <i>Evidenca Nr.48 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ e konfirmon se pas shqyrtimit të evidencave të vena në dispozicion nga Sekretaria Mësimore se statistikat vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master janë të përditësuara me tërheqjet apo largimet para përfundimit të programit, deri tek diplomimet si dhe ata që nuk i kanë përfunduar ende studimet me sukses atë vit akademik. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th><th>Transferime</th><th>Totali</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>42 studentë</td><td>3</td><td>45 studentë</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>43 studentë</td><td>1</td><td>44 studentë</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>45 studentë</td><td>0</td><td>45 studentë</td></tr></table> <i>Evidenca tek dokumentet shtesë Nr. i të rregjistruarve.</i>	Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Totali	2020-2021	42 studentë	3	45 studentë	2021-2022	43 studentë	1	44 studentë	2022-2023	45 studentë	0	45 studentë
Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Totali														
2020-2021	42 studentë	3	45 studentë														
2021-2022	43 studentë	1	44 studentë														
2022-2023	45 studentë	0	45 studentë														
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ provoi gjatë vizitës në UMSH se të dhënat statistikore të studentëve si të dhënat personale, numri i matrikullimit, nota mesatare, etj., menaxhohen nga Sekretaria Mësimore përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Shkëmbimi i të dhënave sipas rastit realizohet me anë të komunikimit zyrtar midis drejtuesit të Departamentit dhe sekretarisë të cilat ishin tepër korrekte sipas konfirmimit të të dy palëve. <i>Evidenca Nr.48 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>																
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ pasi shqyrtoi aktet rregullatore të UMSH, si dhe referuar vizitës në institucion për konfirmimin e sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave statistikore të studentëve, vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike e Marrdhënieve Ndërkombëtare i ka të pasqyruara këto në raportet periodike të tij për çdo vit akademik. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare nga titullari i lëndës, sekretaria mësimore i pasqyron notat si në regjistra edhe në bazën elektronike të të dhënave. <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit të UMSH; Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit Evidenca 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike e Marrdhënieve Ndërkombëtare</i>																



	<i>Evidenca Nr.48 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjuesve.	GVJ nga biseda me drejtuesit e institucionit, të Fakultetit dhe të Departamentit dhe shqyrtimi i analizës të tregut për periudhën 2017-2021 që i referohet të gjitha degëve që ofron UMSH, vlerëson se ata e kishin në vëmendje cilësinë e studentëve në këtë degë studimi Master, ndonëse në një proces verbal mbledhjeje të fundvitit 30.6.2023 në rendin e ditës janë aspektet formale të komisioneve të provimeve. Nisur edhe nga perspektiva e punësimit të studentëve, Departamenti në 2018 e orientoi programin e studimit Master drejt lidhjes së shkencave politike me zhvillimin e qendrueshëm ekonomik.			
	<i>Evidenca 12. Procesverbal Mbledhje Dep. Shkencave Politike</i> <i>Evidenca 15. Analiza e tregut të punës</i> <i>Evidenca 49. Formulari i Studentit Alumni</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH, si institucion i arsimit të lartë respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre pas diplomimit. Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon pyetësor me studentët e programit të studimit mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre	Nga biseda e GVJ me drejtuesit e institucionit dhe shqyrtimi i Statutit, Rregullores së UMSH, Rregullores së Fakultetit, të Departamentit, si dhe Rregullores së programit të studimit konfirmohen specifikimet e procedurave të përfshirjes së

Masa



në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	studentëve në vendimarrje. Po ashtu, nga biseda me studentët doli qartë se ata janë të familjarizuar dhe të angazhuar me çfarë aktivitetesh zhvillohen në Departament pasi ata ftohen në mbledhje ku ka për tu marrë ndonjë vendim që i ndikon ata. Në nivel institucioni, përfshirja e studentëve në vendimarrje si në Këshillin Studentor ku aktiviteti i tyre rrit përfshirjen e studentëve në vendimarrjen e UMSH. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.</i> <i>Evidenca 50. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor.</i> https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ krahas shqyrtimit të dokumentacionit të Universitetit dhe Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si Statutit dhe Rregulloreve përkatëse që sanksiononin pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, nga bisedat me stafin akademik dhe studentët konfirmon se në fund të çdo semestri studentët vlerësonin procesin mësimor dhe çdo lëndë të programit Master. Ky vlerësim merrej në konsideratë nga stafi akademik dhe drejtuesit që reflektonin rezultatet e anketimit të studentëve. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH;</i> <i>Evidence 25. Formular i vlerësimit të pedagogut dhe të lëndës nga studenti;</i> <i>Evidenca 31. Procedurat e punes me fokus grupet;</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e NJSBC</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ gjykon se studentët ishin aktive në diskutime për përmirësimet të programit të studimit, edhe pse numri i tyre ishte i vogël. Kjo ka qenë një nxitje më shumë për Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për t'i përfshirë ata në diskutime qoftë në mbledhje departamenti, apo me pyetësorë për përmirësimin e programit të studimit që organizohen nga njësia e sigurimit të cilësisë. Opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve, etj. Institucioni e ka praktikë të përvitshme marrjen e mendimeve të studentëve aktualë edhe të atyre që janë të diplomuar përmes anketimeve për procesin e përmirësimit të programit të studimit. <i>Evidence 25. Formular i vlerësimit të pedagogut dhe të lëndës nga studenti;</i>




	<i>Evidenca 31. Procedurat e punes me fokus grupet; Evidenca 51. Rregullore e ZKSK</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Krahës dokumentacionit të UMSH që përcakton mundësitë e studentit të shprehë opinionet përmes kanaleve formale të institucionit, si edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit dhe rishikimit të notës nga pedagogu, GVJ në bisedën me studentët dëgjoi shembuj që ata sollën për fleksibilitetin e stafit akademik lidhur me procesin e vlerësimit të dijeve të tyre. Brenda dy ditëve që është koha e korrigjimit të provimeve, studentët informohen për rezultatet dhe nëse ka Nën pakënaqësi ata kanë të drejtë konsultimi dhe pastaj nëse nuk bien dakort bëhet ankimimi, por nga biseda me ta nuk kishte arritur puna deri në këtë pikë. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH. Evidenca 8. Rregullore e DSHPMN. Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në argumentet e evidentuara në pjesën përshkrimore. Si përmes dokumentacionit të plotë të UMSH apo Departamentit, studentëve u mundësohet dhënia e mendimit dhe pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes si nga UMSH përmes Këshillit Studentor, edhe nga Departamenti ku studentët ftohen në mbledhjet e Departamentit, plotësojnë pyetësorë për procesin e vlerësimit të programit të studimit, përfshirë edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të notës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	GVJ vlerëson se UMSH ka një dokumentacion të plotë për përcaktimin e procedurave e strukturave të posaçme për informimin dhe mbështetjen e studentëve. Departamenti dhe stafet akademike ndihmojnë për të orientuar e bashkëpunuar ngushtë me studentët për procesin mësimor në funksion të realizimit të programit të studimit. Sekretarët sigurojnë shkëmbimin e

ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	informacionit me studentët për provimet, notat, oraret, etj. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) shërben për orientimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave të tyre deri te këshillimi për punësim. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH.</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.</i> <i>Evidenca 51. Rregullore ZKSK.</i> https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nga takimi i GVJ me Departamentin dhe NJSBC konkludohet se UMSH ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin dhe tërheqjen e mendimeve dhe ideve të studentëve lidhur me çështje të procesit mësimor dhe programin e studimit Master. Departamenti orienton politikat e tutorialit për mbarëvajtjen e procesit mësimor, kurse Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ofron shërbime orientuese në dobi të karrierës së studentëve, dhe Këshilli Studentor mundëson përcjelljen e informacioneve të studentëve në strukturat vendimarrëse si një hallkë e rëndësishme në jetën studentore. <i>Evidenca 36. Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidenca 50. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor.</i> <i>Evidenca 51. Rregullore ZKSK.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ka si funksion parësor të saj orientimin e studentëve gjatë ciklit të plotë akademik, ofrimin e mundësive për praktikat profesionale dhe trajnime për përfshirjen e studentëve në tregun e punës. Zyra vepron edhe duke aktivizuar rrjetet alumni të të diplomuarve për tu sjellë studentëve modele pozitive. Nëpërmjet ofrimit të mundësive për praktikat profesionale duke përdorur marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ana e institucionit, studentëve ju jepet edhe një mundësi punësimi bazuar në aftësitë që ata demonstrojnë. <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH.</i> <i>Evidenca 51. Rregullore ZKSK.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh,	Nga biseda e GVJ me përfaqësuesen e ZKSK vlerëson bashkëpunim me ALUMNI të UMSH për kontakte të vazhdueshme duke i sjellë disa prej tyre si modele suksesi për të

Masa

përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	motivuar edhe studentët aktualë me ecurinë e karrierës së tyre profesionale mbas përfundimit të studimeve. Ata janë një urë lidhëse midis programit të studimi dhe tregut të punës. <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UMSH.</i> <i>Evidenca 51. Rregullore ZKSK.</i> https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UMSH ka të përcaktuara procedura e njësi të posaçme për orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave të tyre përgjatë gjithë ciklit mësimor. Departamenti koordinon veprimtarinë e tij me të gjitha strukturat e UMSH të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme në mbështetje të studentëve. Faqja online e UMSH gjithashtu lehtëson marrjen e çdo informacioni nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	GVJ vlerëson që UMSH ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ka krijuar strukturat përgjegjëse si NJSBCZHK dhe aktet rregullative mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive të mësimdhënies. Institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional me qëllim që të garantojë përdorimin e metodave të

fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në të gjitha fushat e studimit. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH.</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e NJSBCZHK</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	NJSBCZHK i vuri në dispozicion GVJ gjatë takimit në UMSH formularë të aplikuar në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatori i programit vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik si përmes formularëve të vetëvlerësimit, të vlerësimit nga drejtuesit dhe nga studentët për çdo lëndë në fund të semestrit, sikurse edhe mbi bazën e treguesve të aktivitetit të tyre shkencor. Në kuadrin e projekteve të ndryshme stafet akademike motivohen e trajnohen për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe njohjen e metodave inovative. Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore në përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimit të programeve të studimit. <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti.</i> <i>Evidenca 29. Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues.</i> <i>Evidenca 30. Plani i monitorimit DSHPMN.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike mundëson përfshirjen e studentëve përmes formularëve e pyetësorëve, ku edhe vetë pedagogët në fund të lëndës u kërkojnë një vlerësim studentëve të Masterit për procesin e mësimdhënies. NJSBCZHK zhvillon takime të përmuajshme me Këshillin Studentor, kjo njësi zhvillon focus grupe me studentët e çdo programi studimi ku diskutojnë për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Përfshirja e studentëve zhvillohet edhe nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve për çdo semestër. Rezultatet e tyre, NJSBCZHK ua bën me dije drejtuesve të institucionit dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti.</i>




	<i>Evidenca 31. Procedura e punës me fokus grupet.</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përgjegjësi i Departamentit gjatë bisedës në institucion konfirmoi se ai i komunikon në mbledhje rezultatet e përgjithshme dhe pastaj çdo pedagogu në veçanti ato specifike. Mbi bazën e analizës së rezultateve të anketimit, departamenti nxjerr problematikat dhe reason për përmirësimin e tyre. UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar në faqen online të cilat GVJ i konfirmoi gjatë vizitës në institucion, pra janë transparente për të gjithë të interesuarit. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Promovimi i përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor rezulton nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, të cilët përfshihen në projektet kërkimore shkencore edhe me ekipe të huaja, si në projektet COST, Erasmus, etj. Referuar pedagogëve, ata demonstrojnë se institucioni i ka mbështetur në avancimin në karrierën e tyre përmes marrjes së gradave Doktor, Prof.Asoc. dhe Profesor. Të gjitha vlerësimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies administrohen nga Rektori në mënyrë që ti shërbejnë promovimit në nivel institucional të modeleve më të mira.			
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht pasi UMSH ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, ka krijuar strukturat përgjegjëse si NJSBCZHK dhe aktet rregullative mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive dhe monitorimin përmes fokus grupeve, formularëve të vlerësimit të studentëve për pedagogët dhe lëndët, krahas vlerësimit nga titullarët. Përmes projekteve të ndryshme, UMSH mbështet promovimin e vazhdueshëm të rritjes së stafit akademik dhe të njohjes së praktikave më të mira.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konfirmon se UMSH respekton kuadrin ligjor për krijimin e strukturave për sigurimin e cilësisë në nivel institucional si NJSBCZHK, ka politika e procedura për vlerësimin periodik të veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore për sigurimin e cilësisë të saksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UMSH. NJSBCZHK vlerëson periodikisht standardet e cilësisë së veprimtarive mësimore e kërkimore. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH.</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH Kreu IV, Neni 28.</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka rishikuar programin e studimit të ciklit të dytë Master në vitin 2018 për ta përmirësuar programin, për ta bërë më të përshtatshëm për kërkesat e studentëve punësimit e tyre. Bazuar në rezultatet e focus grupeve, pyetësorëve me studentët dhe vlerësimet e stafit akademik, si dhe në bashkëpunim me aktorë të komunitetit, si institucionet publike/ OSHC ku studentët zhvillojnë praktikën, si dhe marrëveshjet institucionale me Bordin e Tregut të Punës, Departamenti ka qenë i nxitur për përmirësimet e nevojshme të programit të studimit. Po ashtu, përmes bashkëpunimeve me aktorë të jashtëm si universitetet me të cilat kanë projekte të përbashkëta, janë përmirësuar kurrikulat dhe syllabuset e lëndëve, sikurse dhe publikimet e stafit akademik. Në strategjitë e këtij institucioni dhe të programit Master vend të rëndësishëm zë tërheqja e mendimit të studentëve si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm në kuadër të Sigurimit të Cilësisë. <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH;</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit Master</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të	UMSH përdor instrumente dhe tregues të ndryshëm për sigurimin e jashtëm të cilësisë përmes proceseve të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit në bashkëpunim me ASCAL. UMSH e ka kaluar me sukses akreditimin e jashtëm institucional, kurse programi i studimit po kalon fazën e vlerësimit periodik, pas riorganizimit në vitin 2018. Bazuar në evidencat e dosjes së RVB, UMSH ka dhënë tregues të matshëm dhe procedurat shprehen

akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	qartësisht në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, sikurse specifikohet edhe në RVB. Gjithashtu brenda UMSH, NJSBCZHK përdor instrumenta dhe metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta që përmirësojnë cilësinë e programit të studimit. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH;</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH;</i> <i>Raportet e akreditimit institucional dhe të programit të studimit në faqen zyrtare online të ASCAL</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ pas takimeve me stafin akademik dhe përgjegjës të Departamentit, me Dekanin e Fakultetit dhe NJSBCZHK gjykon se institucioni përdor tregues të ndryshëm të qartë dhe të matshëm si për mësimdhënie edhe kërkim shkencor për vlerësimin e cilësisë. Ato pasqyrohen në raportet e NJSBCZHK, në strategjitë institucionale, në evidencat statistikore dhe në formatet e vlerësimit të stafit akademik. Rezultatet e anketimeve të studentëve tregojnë matjet e performancës së pedagogëve sipas disa kriterëve të standartizuara në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë nxit stafet akademike të afirmohen më tej në pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare COST dhe Erasmus+. <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH;</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit Master</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në shqyrtimin e politikave, strukturave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Periodikisht janë kryer vlerësime të brendshme dhe të jashtme, si për akreditimin institucional edhe atë të programit të studimit Master Shkencor i cili u rimodelua në vitin 2018, për rritjen e cilësisë, përgjigjes ndaj nevojave të studentëve dhe kërkesave të tregut. Ndërsa vlerësimet e jashtme bëhen në bashkëpunim me ASCAL, vlerësimet e brendshme kryhen përmes një procesi të bashkëpunimit mes strukturave të brendshme si NJSBCZHK, Departamentit, studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm me të cilët Departamenti ka marrëveshje për praktikantë të studentëve. Metodat janë të ndryshme, që nga pyetësorët për studentët, formularët e

	vlerësimit të stafit akademik, diskutimet në Departament deri tek monitorimet nga drejtuesit e UMSH. Reflektimet pasqyrohen në raporte të cilat janë transparente për të gjithë në faqen online të UMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ pas shqyrtimit të akteve institucionale si Statuti, Rregullore dhe të objektivave të strategjisë së UMSH dhe të strategjisë së programit të studimit, si dhe pas bisedës me stafin akademik si Rektorin, Dekanin, përgjegjësin e Departamentit dhe NJSBCZHK konfirmon se ky program studimi Masteri Shkencor ka kaluar në procese shqyrtimi që me rishikimin e lëndëve, syllabuseve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Këto procese janë të dokumentuara në vendimet për rimodelimin e tij ku pasqyrohen arritjet, problematikat dhe masat për kapërcimin e tyre për të siguruar përmirësimin e programit të studimit. Pjesë e këtij procesi janë edhe vlerësimet e studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve të dokumentuara në raportet përkatëse si dhe raportet e vlerësimit të stafit akademik. Rezultatet e vlerësimeve u përcillen autoriteteve përgjegjëse, në mënyrë që të gjithë të njihen me arritjet apo dobësitë dhe janë transparente dhe të aksesueshëm për këdo në faqen online të UMSH. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH;</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit Master</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf https://www.umsh.edu.al/media/64ba73a87246c.pdf
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë	Nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit, GVJ gjykon se ato përmbajnë analiza të të dhënave statistikore, të studentëve të

Mase

[Signature]

rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	regjistruar dhe atyre të diplomuar, që në tre vitet e para të aplikimit të këtij programi studimi kanë qenë në numër të konsiderueshëm, me rreth 45 studentë në program studimi Master Shkencor. Vlerësohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilin pas diplomimit. Po ashtu pasqyrohen rezultate e avancimit të stafit akademik, të pjesëmarrjes së tyre në veprimtari kërkimore shkencore, publikimeve dhe projekteve të Departamentit apo UMSH dhe rezultatet e anketimeve dhe të vlerësimit të stafit akademik. Vlerësimet periodike që pasqyrohen me raportet ku specifikohen arritjet e mangësitë i përcillen rektoratit, dhe prej këtij drejtuesit të njësisë kryesore dhe drejtuesit të njësisë bazë e përmes tyre në mënyrë konfidenciale stafit akademik. Raportet e vlerësimit nga NJSBCZHK përdoren në mbështetje të procesit të promovimit të stafit akademik i cili ka avancuar referuar titujve shkencorë. <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise <i>Evidenca 32. Plani i monitorimit DSHPMN.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ pas bisedave me stafin akademik vlerëson se në matjen e cilësisë së mësimdhënies për këtë program studimi format e vlerësimit janë të larmishme. Konkretisht referuar syllabuseve të përcaktuara nga pedagogët në lëndët e tyre parashikohen teste me shkrim, prezantime me gojë në seminare, apo punë e pavarur me projektet e kursit. Përtej këtij niveli të vlerësimit në auditor, në mënyrë që të sigurohet të mësuarit jo vetëm të koncepteve teorike, por edhe të lidhjes me analiza të situatave konkrete, gjatë kryerjes së praktikës, studentët monitorohen deri në finalizimin e saj me raportet e studentëve. Nga ana tjetër, vlerësojmë se UMSH monitoron realizimin e programit të studimit sipas standardeve shtetërore të cilësisë duke iu referuar dokumentacionit si Rregullore e formate vlerësimi, apo raporteve të shpallura në faqen zyrtare të UMSH. CV e stafit akademik provojnë promovimin e karrierës së tyre akademike dhe profesionalizmin në fushta e tyre të studimit. <i>Evidenca 14.3. CV e stafit akademik</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i> <i>Evidenca 37. Plani i punës së NJSBCZHK.</i>

Masa



Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Nga shqyrtimi i raporteve të NJSBCZHK dhe bisedat me stafin dhe studentët, GVJ vlerëson instrumentat e përdorura për vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit. Këto përfshijnë metodat e NJSBCZHK si sondazhe të opinioneve të studentëve aktualë të cilët japin vlerësimin për pedagogët dhe lëndët sipas formatit të miratuar në UMSH. Po ashtu fokus-grupet me studentë përfaqësues të çdo programi, që zhvillohen sipas një metodologjie të caktuar. Metodatat e drejtpërdrejta me intervista të stafit akademik e ndihmës akademik janë pasqyruar në Rregulloret e UMSH dhe NJSBCZHK. Njësia e ALUMNIT bën sondazhet dhe gjurmon studentët e diplomuar, evidenton problemet në përshtatjen me vendet e punës të njohurive të fituara në programin e studimit dhe përmirësimet e mundshme, si dhe bashkëpunimet me institucionet me të cilat UMSH ka marrëveshje institucionale. <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti.</i> <i>Evidenca 29. Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca 30. Plani i monitorimit DSHPMN.</i> <i>Evidenca 31. Procedura e punës me fokus grupet.</i> https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH i është nënshkruar dhe ka kaluar me sukses proceseve të akreditimit nga ASCAL, si për akreditimin institucional dhe atë të programeve të studimit. Konkretisht UMSH ka vendosur Rregulloret dhe njësi të posaçme si NJSBCZHK për të zbatuar sistemin e brendshëm për vlerësimin e cilësisë për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të programit të studimit. Një nga treguesit janë që syllabuset i kanë pasqyruar saktë këto komponentë si dhe metodat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe pedagogët i zbatojnë ato në mënyre rigoroze sikurse rezulton nga sondazhet me studentët përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve sjellin vlerësimet e tyre për arritjen e synimeve të programit të studimit. Instrument tjetër i vlerësimit të cilësisë janë edhe përshtypjet e bashkëpunëtorëve të institucioneve ku studentët zhvillojnë praktikën, apo të studentëve të diplomuar alumni për problematikat që hasin në tregun e punës. Raportet periodike të NJSBCZHK janë të aksesueshme edhe në faqen online të UMSH.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin si Statutin dhe Rregulloren e UMSH, si dhe Rregulloren e NJSBCZHK, vlerëson se institucioni i ka të parashikuara politikat dhe procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë. Po ashtu, gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmon se këto politika garantojnë e zbatohen përmes një procesi të përfshirjes së strukturave të brendshme si NJSBCZHK, Departamenti me stafin e tij, tërheqjes së mendimit të studentëve, të ish studentëve, bashkëpunimit me institucionet me të cilat UMSH ka marrëveshje për praktikantët e studentëve dhe ASCAL. Këto janë reflektuar në përmirësimin e programit të studimit i cili është riorganizuar në vitin 2018 për përmirësimin e kurrikulës dhe tërheqjes së studentëve, duke arritur në shifra të rregjistruarve me rreth 45 studentë në tre vitet e fundit akademike. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i> <i>Evidenca 37. Plani i punës së NJSBCZHK.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin si Statutin dhe Rregulloren e UMSH vlerëson se përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara dhe të specifikuara më tej në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NJSBCZHK për monitorimin e cilësisë ka përcaktuar formate për vlerësimin e pedagogut dhe lëndës nga studenti; fokus grupet e studentëve të të gjitha viteve dhe programeve, takimet me Këshillin studentor si dhe kontaktet me të gjitha njësitë e tjera të UMSH. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ të përfshirë për sigurimin e cilësisë bëhen të qarta në Rregulloren e NJSBCZHK dhe udhëzimet për procese të caktuara. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH</i>

Masa



	<i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Përmes raporteve të vlerësimit të vëna në dispozicion dhe bisedave të GVJ me stafet akademike dhe studentët konfirmon se institucioni garanton ushtrimin me përgjegjësi të detyrave për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit përmes strukturave përgjegjëse si NJSBCZHK, në bashkëpunim me personelit akademik, ndihmës akademik të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, duke kërkuar vlerësimet periodike të studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Këto rregulla procedurale janë të sanksionuara edhe në Statutin dhe Rregulloren e UMSH dhe të provuara edhe në RVB për këtë program studimi ku ekipi përbëhej nga pedagogë të Departamentit, të stafit administrative dhe studentëve. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i> <i>Evidenca 30. Plani i monitorimit DSHPMN.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit GVJ konfirmon se ato respektojnë etikën dhe integritetin akademik të personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Sikurse u diskutua me përgjegjësen e Departamentit dhe të NJSBCZHK, për çdo vërejtje konkrete në adresë të stafit akademik që ka dalë nga procesi i vlerësimit, ata kontaktohen veçmas duke shmangur çdo keqkuptim për këtë proces. Po ashtu, edhe vlerësimet e studentëve janë anonime, për të siguruar çdo qëndrim negativ ndaj kritikave të tyre. Specifikisht këto standarde referohen në Rregulloren e NJSBCZHK. <i>Evidenca 36. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të	Në procesin e vlerësimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UMSH ka përfshirë edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi, bazuar në Rregulloret ku përcaktohen kriteret të tilla të funksionimit të këtij sistemi. Bashkëpunëtorët apo ekspertët e jashtëm, të cilët në rastin e Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë edhe të diplomuarit e tij të punësuar në institucione ku ftojnë dhe supervizojnë praktikantët e studentëve, si dhe japin ekspertizat e tyre për tematika të lidhura me programin e



vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	studimit gjatë aktiviteteve ku ata janë ftuar në UMSH si konferenca, takime, promovime librash, etj. Këto i kanë shërbyer përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 36. Rregulloret e organizimit dhe punës së NJSBCZHK.</i>			
Konkluzione	GVJ konfirmon se UMSH ka të përcaktuara qartë politikat dhe rregulloret për proceset e SBC së programit të studimit. Njësitë si NJSBCZHK, Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit për pyetësorët me studentët, Drejtuesi i Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, personeli akademik dhe studentët e diplomuar bashkëpunëtorët e jashtëm në marrëveshje institucionale stafet ndihmës akademike, studentët apo të tjerë bashkëpunëtorë janë të përfshirë dhe informohen në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre përmes konferencave, takimeve, raporteve, aktiviteteve të organizuara në UMSH, si dhe janë bërë publike në faqen online të UMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstatoi se transparenca si parim saksionohet si në Statutin dhe në Rregulloren e UMSH. Të gjitha politikat, strategjitë dhe organizimi për Sigurimin e Cilësisë janë transparente përmes shpërndarjes së informacionit nëpërmjet njësive të ndryshme të UMSH, nga NJSBCZHK tek drejtuesit e UMSH dhe prej tyre tek Departamenti i cili i bën prezente në takimet/mbledhjet me stafin dhe studentët e programit të studimit. Po ashtu, përmes konferencave shkencore ndërkombëtare me pjesëmarrje të ekspertëve vendas dhe të huaj, aktiviteteve të shumta shkencore si promovimet e librave apo leksionet e hapura me debatet mes studentëve dhe të ftuarve, profesorë dhe ekspertë të fushës promovohet kualifikimi i stafit akademik dhe arrijtet e tyre. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Sigurimit të cilësisë dhe ruajtjes së standarteve në UMSH i tregohet kujdes i veçantë dhe konsiderohet prioritet për secilin punonjës, akademik apo staf mbështetës. Informimi për rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit kryhet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBCZHK. Të gjitha raportet, vlerësimet dhe sygjerimet e kësaj njesie pasi përcillen në rektorat, administrohen nga ky i fundit në mënyrë që ti shërbejnë njësive kryesore dhe njësive bazë për përmirësimin e programeve dhe reflektimin për rritje dhe ruajtje të cilësisë për çështje të ndryshme. Në faqen online shpallet një raport përmbledhës i NJSBCZHK, raporti i detajuar me emra të veçantë qëndron në rektorat dhe u bëhet me dije gjithsecilit përgjatë matjes së performancës në fund të vitit akademik, duke respektuar në këtë mënyrë lirinë akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare bazuar në rezultatet e vlerësimit, angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime në ndryshime të programit të studimit, avancime të karrierës së stafit akademik, rritje të bashkëpunimit me institucione të tjera, ndryshime rrënjësore për riorganizimin e këtij programi studimi në 2018.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ nga bisedat me drejtuesit e Rektoratit, Fakultetit dhe të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare vlerëson ecurinë e strategjive të ndjekura në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë dhe rimodelimin e programit të studimit në 2018 për përmirësime të mëtejshme. Projektet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda e jashtë vendit i shërbejnë këtij qëllimi. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare organizojnë takime informuese me personelin akademik dhe studentët për rritjen e ndërgjegjësimin të personelit me trajnime mbi standardet e cilësisë. Referuar CV së stafit akademik rritja e nivelit të kualifikimit të tij, e titujve e gradave shkencore tregon se UMSH ka siguruar rritjen e cilësisë së stafit e për rrjedhojë të procesit mësimor. Po ashtu, Departamenti informon

afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	studentët me kërkesat mbi cilësinë që nga fillimi i vitit akademik e në vazhdim ku si pedagogët për lëndët respektive edhe stafet administrative qartësojnë elementë të ndryshë të programit të studimit. Aktiviteti i NJSBCZHK ka një rol të veçantë në këtë drejtim me tërheqjen e opinioneve të studentëve për sigurimin e cilësisë. Evidenca 14.3 CV e stafit të programit Evidenca 27. Programi i trajnimeve 2022-2023.			
Konkluzione	GVJ vlerëson se politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë transparente për të gjithë aktorët e interesuar, strukturat përgjegjëse të UMSH, stafet akademike, duke u diskutuar në takime brenda Departamentit dhe studentët, si ata aktualë edhe ata të diplomuar në evente të organizuara në UMSH ku ata ftohen të ndajnë përvojat e tyre. Po ashtu, raportet e vlerësimit të brendshëm janë të publikuara në faqen online të UMSH me synim krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është riorganizuar për t’ju përshtatur më mirë Planit strategjik të zhvillimit, statutit dhe rregullores së UMSH, të jetë në harmoni me interesat kombëtare të vendit, duke kontribuar në formëzimin e specialistëve të fushës të aftë të zhvillojnë më tej Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.



2. Stafi akademik me përvojë të spikatur në fushat respektive dhe me karrierë akademike në ngjitje.
3. Pjesëmarrës në projekte të kërkimit shkencor kombëtare e ndërkombëtare. Përdorimi i fondeve të BE përmes projekteve COST dhe Erasmus+ për mobilitetet dhe rrjetëzim.
4. Infrastrukturë moderne për zhvillimin e procesit mësimor, mësimdhënie dhe mësimnxënie.
5. Transparenca me raportet e vlerësimit të cilësisë në faqen online të UMSH.
6. Bashkëpunime të frytshme me institucionet publike e jopublike në vend si dhe me universitetet e huaja.
7. Përvoja interesante me Bordet e Tregut të Punës të ngritura në nivel Departamenti për lidhjen e teorisë me praktikën.
8. Revistat shkencore dhe Shtëpia botuese e UMSH rrisin mundësinë për publikime të stafit akademik, ndonëse stafi akademik i Departamentit nuk kishte përfutur, përveç Prof.A.C. që angazhohej në mësimdhënie për këtë program studimi.
9. Konferencat studentore u japin mundësi studentëve të bëhen pjesë aktive e veprimtrive shkencore të UMSH, ndonëse duhet të rritet përfshirja e tyre në projektet kërkimore të stafit, referuar nivelit Master Shkencor të tyre.

Pika të dobta

1. Mospërputhje e fushës së programit të studimit (Shkenca Sociale, ISCED kategoria 3) me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë (ISCED kategoria 4) dhe Shkencave Humane (ISCED kategoria 2). Pra, edhe emërtimi i njësisë kryesore bashkon dy fusha studimi të kategorive të ndryshme sipas ISCED (Standardi I).
2. Në lidhje me rekomandimet e pikës a, UMSH dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vazhdimësi kanë bërë rishikimin në planet mësimore, por ende nuk kanë përfshirë lëndë me zgjedhje si pjese e aktiviteteve formuese të kategorisë E ku mbetet vetëm mikroteza me 18 ECTS.
3. Literatura në Bibliotekën e UMSH ndonëse e pasur, sikurse edhe syllabuset, kanë kufizime në referencat me botimet më të reja të 5 viteve të fundit në shkencat politike.
4. Faqja zyrtare e UMSH nuk është e përditësuar referuar programit të studimit. Në faqen zyrtare të UMSH ka mospërputhje të krediteve të lëndëve të programit të studimit (Evidenca 14.), konkretisht mikroteza është me 18 ECTS, kurse 20 ECTS në website, sikurse edhe për praktikën ku figurojnë 12 ECTS nga 15 ECTS që janë referuar në linkun: <https://www.umsh.edu.al/media/6530f0148a8e1.pdf> (parë me 21.04.2024, ora 8:00 am).

Rekomandime

1. Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane, kërkohet reflektim nga institucioni, në lidhje me ndërtimin e Fakultetit ku përfshihen nën një emërtim fusha të ndryshme studimi sipas klasifikimit ndërkombëtar ISCED.




2. Institucioni të përshtasë planin mësimor të programit të studimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi duke përfshirë lëndë me zgjedhje si pjesë e aktiviteteve formuese të kategorisë E, ku ende mbetet vetëm mikroteza me 18 ECTS (Evidenca 14.).
3. Shtëpia botuese e UMSH të mundësojë/ mbështesë publikime të stafit akademik të Departamentit që angazhohet në mësimdhënie për këtë program studimi.
4. Departamenti t'u japi mundësi studentëve të bëhen pjesë aktive e veprimtrive shkencore si të projekteve kërkimore të stafit, referuar nivelit Master Shkencor të tyre që kërkon finalizimin e diplomës me një studim original të cilat pastaj t'i paraqesin në konferencat studentore që janë një përvojë positive e UMSH.
5. Përditësimi i vazhdueshëm i literaturës në Bibliotekë me libra fizike, si edhe i syllabuseve me botimet më të reja të 5 viteve të fundit në shkencat politike.
6. Të përditësohet faqja zyrtare online e UMSH, konkretisht të përditësohen kreditet për mikrotezën nga 20 ECTS në 18 ECTS, sikurse edhe për praktikën nga 15 ECTS në 12 ECTS, referuar në linkun: <https://www.umsh.edu.al/media/6530f0148a8e1.pdf> (parë me 21.04.2024, ora 8:00 am).

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Political Sciences and Economic Development Strategies" provided by the Higher Education Institution "Mediterranean University of Albania"

Strengths and affirmations

1. The study program has been reorganized to better suit the Strategic Development Plan, the Statute and Regulation of the UMSH, to be in harmony with the national interests of the country, contributing to the formation of specialists capable of further developing the National Strategies for Development and Integration.
2. Academic staff with prominent experience in the respective fields and with an academic career on the rise.
3. Participate in national and international scientific research projects. Use of EU funds through COST and Erasmus+ projects for mobilities and networking.
4. Modern infrastructure for the development of the teaching and learning process.
5. Transparency with quality assessment reports on the UMSH online page.
6. Fruitful collaborations with public and non-public institutions in the country as well as with foreign universities.




7. Interesting experience with the Labor Market Boards set up at the Departmental level for linking theory with practice.
8. Scientific journals and publishing houses of UMSH increase the possibility for academic staff publications. However, the academic staff engaged in this study program didn't benefit from this publishing house, except Prof.A.C.
9. Student conferences give students the opportunity to become an active part of the scientific activities of UMSH. However, their engagement in research projects of the academic staff has been not adequate referring to the Master of Science level of studies.

Weaknesses

1. Inconsistency of the field of the study program (Social Sciences, ISCED category 3) with the main unit, the Faculty of Law (ISCED category 4) and Human Sciences (ISCED category 2). So, even the name of the main unit, Faculty, includes two fields of study of two different categories according to ISCED (Standard I).
2. In relation to the recommendations of point a. from the previous accreditation, UMSH and the Department of Political Sciences and International Relations have continuously revised the teaching plans, but have not yet included optional subjects as part of the formative activities of category E, where only the micro-thesis with 18 ECTS remains.
3. The literature in the UMSH Library, although rich, as well as in the syllabuses of this study program, have limitations in references to the newest publications of the last 5 years in the field of political sciences.
4. The official website of UMSH is not updated concerning the study program. On the official website of UMSH there is a discrepancy in the credits of the subjects of the study program (Evidence 14.), specifically the micro-thesis is 18 ECTS, while 20 ECTS on the website, as well as for the practice where 12 ECTS appear from the 15 ECTS, referred to the link: <https://www.umsh.edu.al/media/6530f0148a8e1.pdf> (viewed on 21.04.2024, 8:00 am).

Recommendation

1. Referring to the inconsistency of the field of the study program with the main unit, the Faculty of Law and Human Sciences, reflection is required from the institution, regarding the establishment of the Faculty where different fields of study, 2, 3, and 4 according to the international ISCED classification, are included under one name.
2. The institution should adapt the curriculum of the study program in accordance with the by-laws in force, including optional subjects as part of the formative activities of category E, where only the micro-thesis with 18 ECTS remains (Evidence 14.).

Mase



3. The publishing house of UMSH to enable/support publications of the Department academic staff who is engaged in teaching for this study program.
4. The Department should give students the opportunity to become an active part of scientific activities such as staff research projects, referring to the Master of Science level of this program, which requires the finalization of the degree with an original research study which they may present at the student conferences that are a positive experience of UMSH.
5. Continuous updating of the literature in the Library with physical books, as well as the syllabuses with the newest editions of the last 5 years in political sciences
6. To update the official website of UMSH, specifically to update the credits of microthesis from 20 ECTS to 18 ECTS, as well as of the practice from 15 ECTS to 12 ECTS, referred to the link: <https://www.umsh.edu.al/media/6530f0148a8e1.pdf> (first seen on 21.04.2024, 8:00 am).

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X

Masa

[Signature]

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Masa

[Signature]

